

**UNIVERSITETI I PRISHTINËS “HASAN PRISHTINA”**  
**FAKULTETI I EDUKIMIT**  
**DREJTIMI: MËSIMDHËNIA DHE KURRIKULA**



**TEZA MASTER**

**Përfshirja e prindërve në realizimin e detyrave të shtëpisë të nxënësve të shkollës fillore në shkallën e dytë të kurrikulës**

Mentore:

Prof.Asoc.Hatixhe Ismajli

Studentja:

Gresa Salihu

*Prishtinë, 2022*

FAKULTETI I EDUKIMIT

Studimet Master

PROGRAMI: MËSIMDHËNIA DHE KURRIKULA

TEZË MASTERI

E paraqitur nga: Gresa Salihu

Me kërkim të gradës shkencore

Master

Mentore: Prof. Asoc. Hatixhe Ismajli

Tema: Përfshirja e prindërve në realizimin e detyrave të shtëpisë të nxënësit e shkollës fillore në shkallën e dytë të kurrikulës

Mbrohet para komisionit vlerësues të përbërë nga:

1. Prof. Asoc. Hatixhe Ismajli \_\_\_\_\_ (mentore)
2. Prof. Asoc. Ganimete Kulinxha \_\_\_\_\_ (kryetare e komisionit)
3. Prof. Asoc. Vjollca Ahmedi \_\_\_\_\_ (anëtare e komisionit)

## **Deklaratë e autorit mbi origjinalitetin e punimit**

Duke ditur përkufizimin dhe format e plagjiaturës në botën akademike, deklaroj se punimi im nuk cenon të drejtën e autorit të askujt.

Unë deklaroj nën përgjegjësinë time të plotë, se punimi është origjinal i kryer personalisht nga unë. Ky punim, apo pjesë të tij, nuk janë prezantuar dhe botuar më parë nga ndonjë institucion tjetër.

Punimi nuk përmban material të shkruar nga ndonjë person tjetër, përveç rasteve të cituara dhe referuara sipas standardeve të praktikave referuese.

## **Author's statement on the originality of the work**

Knowing the definition and forms of plagiarism in academia, I declare that my work does not infringe anyone's copyright.

I declare under my full responsibility, that the work is original done personally by me. This paper, or parts of it, have not been previously presented and published by any other institution. The paper does not contain material written by any other person, except in cases cited and referred to according to the standards of reference practices.

**Emri/Name**

**Nënshkrimi/Signature:**

**Data/Date:**

Gresa Salihu

\_\_\_\_\_

\_\_\_\_\_

© [2022]-[Gresa Salihu] Të gjitha të drejtat të rezervuara.

*Prindërve të mi...*

*Për dashurinë, besimin dhe mbështetjen e tyre të vazhdueshëm për të arritur majat e suksesit dhe çdo qëllim të cilin e synoj, të cilëve iu detyrohem për çdo arritje në jetën time.*

# Falenderimet

Fillimisht, falenderoj Fakultetin e Edukimit: Programi: Mësimdhënie dhe Kurrikulë që më dha mundësinë për të studiuar në programin “Master”.

Një falënderim të veçantë për profesoreshën mentore, Prof. Hatixhe Ismajli, për bashkëpunimin, sygjerimet dhe këshillat profesionale që më ka dhënë gjatë gjithë kohës.

Po ashtu falënderoj drejtorët, mësimdhënësit, prindërit dhe nxënësit e të gjitha shkollave pjesëmarrëse në hulumtim, të cilët përmes përgjigjeve dhe angazhimit të tyre më ndihmuan në realizimin e pyetësorëve dhe intervistës.

Dhe në fund falënderoj familjen time për përkrahjen e vazhdueshme, ndihmën e ofruar, për kohën e tyre që kanë ndarë për të më ndihmuar që të vazhdoj studimet, e po ashtu, për mundësinë që më kanë krijuar për këtë studim.

## **PËRMBAJTJA**

<b>ABSTRAKTI</b> .....	9
Lista e tabelave .....	11
Lista e grafikëve.....	12
Lista e shkurtesave .....	14
<b>I.HYRJE</b> .....	15
1.1.Definimi i problemit. ....	16
1.2.Qëllimi i hulumtimit.....	16
1.2.1.Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat.....	16
<b>II.SHQYRTIMI I LITERATURËS</b> .....	18
2.1.Detyrat e shtëpisë dhe rëndësia e tyre pedagogjike.....	18
2.2. "Me apo pa detyra të shtëpisë".....	19
2.3. Teoritë për përfshirjen e prindërve në detyrat e shtëpisë.....	21
2.4. Niveli i përfshirjes së prindërve në realizimin e detyrave të shtëpisë.....	22
2.5. Detyrimet e rolit prindëror në zhvillimin e fëmijës.....	24
2.6. Mundësitë dhe kërkesat për përfshirje nga fëmija dhe shkolla.....	25
2.7.Detyrat e shtëpisë në shkollën fillore.....	26
2.8.Rëndësia e partneritetit shkollë - familje.....	27
<b>III.METODOLOGJIA E HULUMTIMIT</b> .....	29
3.1.Mostra/Populacioni/Pjesëmarrësit.....	29
3.2.Modeli dhe metodat e mbledhjes së të dhënave.....	31
3.3.Instrumentet e mbledhjes së të dhënave.....	32
3.4.Analiza e të dhënave.....	33
3.4.1.Të dhënat demografike.....	33

3.4.2. Besueshmëria e instrumentit.....	34
<b>IV. REZULTATET E HULUMTIMIT.....</b>	<b>35</b>
4.1. Të dhënat sasiore.....	35
4.1.1. Rezultatet nga anketa me prindër.....	35
4.1.2. Rezultatet nga anketa me nxënës.....	50
4.2. Të dhënat cilësore.....	62
<b>V. INTERPRETIMI DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE.....</b>	<b>66</b>
5.1. Diskutimi i rezultateve të përceptimit të prindërve, nxënësve dhe mësimitdhënësve për përfshirjen/ ndikimin e prindërve në realizimin e detyrave të shtëpisë .....	67
5.2. Mënyrat më të mira të ofrimit të ndihmës nga ana e prindërve në detyrat e shtëpisë .....	68
5.3. Diskutimi i rezultateve për ndikimin e bashkëpunimit prind - mësimitdhënës për detyrat e shtëpisë në arritjet e nxënësve.....	69
5.4. Diskutimi i rezultateve për vështërsitë që hasin prindërit dhe mësimitdhënësit gjatë realizimit dhe kontrollimit të detyrave të shtëpisë .....	70
5.5. Diskutimi i rezultateve për gjetjen e mënyrave më të mira nga prindërit dhe mësimitdhënësit për realizimin e detyrave të shtëpisë dhe nivelin e bashkëpunimit mes tyre .....	70
<b>VI. PËRFUNDIME DHE REKOMANDIMET .....</b>	<b>72</b>
6.1. Rekomandimet .....	73
6.2. Limitet .....	74
6.3. Implikimet praktike .....	75
<b>REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE.....</b>	<b>76</b>
SHTOJCA 1. Pyetësor për prindër.....	79
SHTOJCA 2. Pyetësor për nxënës.....	82
SHTOJCA 3. Intervista për mësimitdhënës.....	84



## ABSTRAKTI

Detyrat e shtëpisë janë formë themelore e punës së nxënësve në shtëpi. Zakonisht si detyra shtëpie merren të gjitha llojet e mësimit dhe të punëve që i kryen nxënësi kur nuk është në shkollë dhe në lidhje me mësimin shkollor. Në kohën e sotme ndihma e prindërve për t'i kryer detyrat e shtëpisë dhe përfshirja e tyre në procesin edukativo-arsimor është mëse e nevojshme dhe shumë e mirëseardhur.

Metodologjia e cila është përdorur në këtë studim është metoda e përzier, konkretisht, metoda cilësore dhe sasiore. Qëllimi i këtij studimi është të shqyrtojë ndikimin e përfshirjes së prindërve në detyrat e shtëpisë në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies tek nxënësit e shkollës fillore të shkallës së dytë të kurrikulës. Pyetja kryesore e hulumtimit është: Sa ndikon përfshirja e prindërve në procesin e realizimit të detyrave të shtëpisë në suksesin e nxënësve të shkollës fillore të shkallës së dytë të kurrikulës? Ndërsa, për të gjetur përgjigjën e pyetjes hulumtuese më kanë ndihmuar edhe këto nën pyetje: Çfarë roli kanë prindërit në procesin e realizimit të detyrave të shtëpisë te nxënësit e shkollës fillore? Si ndikon bashkëpunimi prind-mësues për detyrat e shtëpisë në arritjet e nxënësve? Hipotezat e hulumtimit janë: Përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë është faktor i rëndësishëm në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies dhe Bashkëpunimi mësues-prind rreth detyrave të shtëpisë ndikon pozitivisht në arritjet e nxënësve. Ky hulumtim është realizuar në gjashtë shkolla publike, katër shkolla të komunës së Vushtrrisë dhe dy shkolla të komunës së Prishtinës, në klasen e tretë, katërt dhe të pestë. Shkollat në komunën e Vushtrrisë janë: “Andon Zako Çajupi”, “Naim Frashëri”, “Ali Kelmendi” dhe “Mustafë Venhari”. Ndërsa në komunën e Prishtinës janë shkollat “Azemi e Salihu”, “Dëshmorët e 1921”. Të dhënat janë siguruar me ndihmën e instrumenteve hulumtuese pyetësorit për prindër dhe për nxënës si dhe intervistës me mësimdhënës.

Të gjeturat e hulumtimit nga ky studim tregojnë që përfshirja e prindërve në procesin e realizimit të detyrave të shtëpisë është faktor i rëndësishëm për ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies e që drejtpërdrejtë ndikon edhe në përmirësimin e rezultateve në mësim, në përforcimin e njohurive dhe arritjeve të rezultateve të dëshiruara në mësim.

**Fjalët kyçe:** detyrat e shtëpisë, prindërit, bashkëpunimi shkollë-familje, nxënësit, shkolla fillore

## ABSTRACT

Homework is the fundamental form of pupils' work at home. Commonly, homework is considered all types of learning and work done by the pupils when they are not in school which is related to school learning. In today's age, parents' help with homework and their involvement in the educational process is necessary and welcome.

The methodology used in the study is a mixed method, concretely, the qualitative and quantitative method. The purpose of this study is to examine the impact of parental involvement in homework completion, and the increase of quality of learning of primary school pupils, belonging to the second level of curriculum. The main research question is: How does parental involvement in homework completion affect the performance of second grade curriculum of primary school pupils. While, in order to help find answers on the main study question, these sub-questions were used: What is the parents' role in homework completion of primary school pupils? How does parent-teacher cooperation regarding homework affect pupils' achievement? Study hypotheses are: Parental involvement in homework is an important factor in quality increase of the learning process and Teacher-parent cooperation regarding homework affects positively pupils' achievement. The study has taken place in six public schools, four of which are part of the Vushtrri municipality and two of Prishtina. The study includes the third, fourth, and fifth grade. Schools from the municipality of Vushtrri are "Andon Zako Çajupi", "Naim Frashëri", "Ali Kelmendi" and "Mustafë Venhari". While those from Prishtina are "Azemi e Salihu" and "Dëshmorët e 1921". The data was obtained with the use of a questionnaire for parents, and one for pupils, as well as the interview with teachers.

The study results show that parents' involvement in the homework completion process is a significant factor for improving learning quality, which also has a direct impact on producing better results, reinforcing knowledge levels, and achieving desired results in teaching.

**Key words:** homework, parents, school-family cooperation, pupils, primary school

## LISTA E TABELAVE

Tabela 1. <i>Tipologjia e Epsteinit për përfshirjen prindërore në shkollë</i> .....	21
Tabela 2. <i>Struktura e sistemit të arsimit para universitar sipas KKK-së</i> .....	33
Tabela 3. <i>Të dhënat për gjininë e prindërve</i> .....	30
Tabela 4. <i>Të dhënat për moshën e prindërve</i> .....	30
Tabela 5. <i>Të dhënat për nivelin e edukimit të prindërve</i> .....	31
Tabela 6. <i>Analiza demografike për pyetëtorin e prindërve</i> .....	33
Tabela 7. <i>Analiza e besueshmërisë për pyetëtorët e prindërve</i> .....	34

## LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. <i>Unë çdo ditë pyes fëmijën tim për detyrat e shtëpisë</i> .....	35
Grafiku 2. <i>Fëmija im ka çdo ditë detyra të shtëpisë</i> .....	36
Grafiku 3. <i>Fëmija im është i ngarkuar me detyra të shtëpisë</i> .....	37
Grafiku 4. <i>Fëmija im me dëshirë i kryen detyrat e shtëpisë</i> .....	38
Grafiku 5. <i>Fëmijës tim çdo ditë ia kontrolloj detyrat e shtëpisë</i> .....	39
Grafiku 6. <i>Përafërsisht sa kohë brenda ditës i ndihmoni fëmijës rreth detyrave të shtëpisë</i> ..	40
Grafiku 7. <i>Cili nga prindërit ndihmon më shumë fëmijën rreth detyrave të shtëpisë</i> .....	41
Grafiku 8. <i>Fëmija im është i pavarur në kryerjen e detyrave të shtëpisë</i> .....	42
Grafiku 9. <i>Gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë ju si prindër i referoheni</i> .....	43
Grafiku 10. <i>Gjatë procesit të kryerjes së detyrave, ju si prindër në cilat faza keni vështirësi</i> ..	44
Grafiku 11. <i>Cila është forma më e zakonshme e ndihmës që i ofroni fëmijës në detyra të shtëpisë</i> .....	45
Grafiku 12. <i>Përfshirjen tuaj në procesin e kryerjes së detyrave të shtëpisë në shtëpi e cilësoni si</i> .....	46
Grafiku 13. <i>Bashkëpunimi mësues-prind rreth detyrave të shtëpisë ndikon në arritjen e rezultateve të të nxënësve</i> .....	47
Grafiku 14. <i>Përfshirja e prindërve në detyra të shtëpisë ndikon në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies</i> .....	48
Grafiku 15. <i>Detyrat e shtëpisë ndikojnë në zhvillimin e të menduarit kritik</i> .....	49
Grafiku 16. <i>Unë çdo ditë në secilën lëndë, sipas orarit mësimor kam detyra të shtëpisë</i> .....	50
Grafiku 17. <i>Çdo ditë prindërit më pyesin për detyrat e shtëpisë</i> .....	51
Grafiku 18. <i>Mësuesja na jep sqarimet e nevojshme rreth detyrave të shtëpisë</i> .....	52
Grafiku 19. <i>Unë me dëshirë i kryej detyrat e shtëpisë</i> .....	53
Grafiku 20. <i>Prindërit më ndihmojnë çdoherë rreth detyrave të shtëpisë</i> .....	54
Grafiku 21. <i>Unë jam i pavarur në kryerjen e detyrave të shtëpisë</i> .....	55
Grafiku 22. <i>Gjithmonë prindërit mi kontrollojnë detyrat e shtëpisë</i> .....	56
Grafiku 23. <i>Detyrat e shtëpisë ndikojnë në përforcimin e njohurive</i> .....	57
Grafiku 24. <i>Detyrat e shtëpisë janë të domosdoshme për të arritur rezultatet e dëshiruara</i> ....	58
Grafiku 25. <i>Përfshirja e prindërve në procesin e kryerjes së detyrave të shtëpisë, ndikon në përmirësimin e njohurive të asaj lënde mësimore</i> .....	59

Grafiku 26. <i>Tek unë gjithmonë detyrat e shtëpisë nxisin të menduarit</i> .....	60
Grafiku 27. <i>Gjatë kontrollimit të detyrave të shtëpisë nga mësuesja, unë kam gabime</i> .....	61

## **LISTA E SHKURTESAVE**

<b>MASHT</b>	Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë
<b>CDE</b>	Qendra për Arsim Demokratik
<b>KKK</b>	Korniza Kurrikulare e Kosovës
<b>OECD</b>	Organizata për Bashkëpunim Ekonomik dhe Zhvillim

## I.HYRJE

Detyrat e shtëpisë krijojnë mundësi për ndërveprime të rëndësishme ndërmjet shkollës, familjes, nxënësve dhe pjesëtarëve të tjerë të cilët i ndihmojnë dhe kujdesen për fëmijën.

Për shkak që ata janë në qendër të procesit të detyrave të shtëpisë, mësimit luajnë rol kritik në ndihmë rreth detyrave të shtëpisë, ndërsa prindërit përfshihen në mënyrë efektive në realizimin e detyrave të shtëpisë së nxënësve. Me qëllim që nxënësit të përvetësojnë dituri dhe të fitojnë shprehje të nevojshme për jetë, është e domosdoshme që të zhvillohet puna sistematike në shtëpi në bazë të detyrave që jep mësuesi. Studimi analizon disa nga aspektet dhe karakteristikat që evidencohen në përvojën e deritanishme të prindërve në bashkëpunimin e tyre me fëmijët, në kuptimin dhe ndihmën e tyre në realizimin sa më të suksesshme të detyrave të shtëpisë.

Puna e suksesshme e nxënësit në shtëpi varet nga ajo se si ka shkuar ora mësimore dhe në ç'mënyrë dhe në ç'masë është ngarkuar nxënësi me detyra të shtëpisë. Sa më me themel të jetë përvetësuar lënda në orë dhe në mënyrë sa më të organizuar të kenë punuar nxënësit në klasë, aq më e suksesshme dhe më e frytshme do të jetë edhe puna e tyre në shtëpi. Detyrat e shtëpisë janë vijimi i punës së zhvilluar në orë dhe përcaktohen prej saj.

Ndonjëherë prindërit u bëjnë presion fëmijëve për t'i përfunduar detyrat e shtëpisë pa dëshirën dhe vullnetin e tyre, ose për t'i kryer me korrektësi edhe pse formimi i tyre i mangët në shumë raste i çorienton fëmijët në kryerjen e tyre sipas pritshmërisë së mësuesit.

Sipas literaturës, përfshirja e prindërve në detyra të shtëpisë ka aspekte pozitive dhe negative, në varësi të sjelljeve të prindërve (Cunha et.al, 2015).

Arsyeja e studimit të kësaj teme rrjedh pikërisht nga faktet e lartpërmendura se ka mendime të ndryshme dhe shumë në dyshim se përfshirja e prindërve në detyra a i ndihmon nxënësit a paraqitet si pengesë për të apo edhe ndikon në varësinë e tepërt të fëmijës tek prindi. Për të gjetur përgjigjet e këtyre pyetjeve kemi bërë një shqyrtim të hollësishëm të literaturës dhe do të realizojmë një pyetësor me prindër dhe me nxënës si dhe intervistë me mësimit rreth temës së përfshirjes së prindërve në detyra. Në fund të studimit nga përfundimet e nxjerra pas analizës së të dhënave të fituara gjatë hulumtimit, do të dalin rekomandime të cilat mund t'u shërbejnë prindërve për ofrim sa më të mirë të ndihmës për fëmijën. Po ashtu, ky studimi i kontribuon, sado pak, edhe zhvillimit të mëtutjeshëm në këtë fushë duke e vështuar nga një këndvështrim i ri dhe duke bërë një hulumtim më të hollësishëm.

## **1.1. Definimi i problemit**

Në vendin tonë kemi shumë për të bërë, sidomos në sistemin e arsimit. E përfshirja e prindërve në jetën shkollore e veçanërisht në detyrat e shtëpisë është element shumë i rëndësishëm i zhvillimit dhe ngritjes së cilësisë në procesin e mësimnxënies.

Edukimi dhe arsimimi i fëmijëve është një ndër çështjet kryesore në sistemin arsimor, andaj për t'i ardhur në ndihmë kësaj shkollat duhet të bashkëpunojnë me familjet e nxënësve e po ashtu edhe prindërit të bashkëpunojnë e kjo arrihet duke u përfshi edhe përmes detyrave të shtëpisë dhe kështu t'iu ndihmojnë edhe fëmijëve në adaptimin e tyre në shkollë dhe ngritjen e cilësisë tek procesi mësimor.

## **1.2. Qëllimi i hulumtimit**

Studimi ka për qëllim të shqyrtojë ndikimin e përfshirjes së prindërve në detyrat e shtëpisë në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies tek nxënësit e shkollës fillore të shkallës së dytë të kurrikulës. Në këtë studim, hulumtimi është i rëndësishëm me qëllim të sqarimit të pozicionit të prindërve lidhur me detyrat e shtëpisë duke fituar kështu një pamje më të qartë dhe më të përgjithshme në përfshirjen dhe mënyrën e përfshirjes së prindërve në detyrat e shtëpisë të nxënësit e shkollës fillore të shkallës së dytë të kurrikulës.

### **1.2.1. Pyetjet e hulumtimit dhe hipotezat**

Ky hulumtim ka për qëllim t'i përgjigjet pyetjes kryesore: *Sa ndikon përfshirja e prindërve në procesin e realizimit të detyrave të shtëpisë në suksesin e nxënësve të shkollës fillore të shkallës së dytë të kurrikulës?*

Ndërsa, për të gjetur përgjigjën e pyetjes hulumtuese do të më ndihmojnë edhe këto nën pyetje ndihmese:



- *Çfarë roli kanë prindërit në procesin e realizimit të detyrave të shtëpisë te nxënësit e shkollës fillore?*
- *Si ndikon bashkëpunimi prind-mësues për detyrat e shtëpisë në arritjet e nxënësve?*

### **Hipotezat e hulumtimit**

Hipotezat e hulumtimit janë:

**H1:** Përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë është faktor i rëndësishëm në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies.

**H2:** Bashkëpunimi mësues-prind rreth detyrave të shtëpisë ndikon pozitivisht në arritjet e nxënësve.

## II.SHQYRTIMI I LITERATURËS

### 2.1. Detyrat e shtëpisë dhe rëndësia e tyre pedagogjike

Detyrat e shtëpisë dëshmojnë se janë veprimtaritë më problemore për mësuesit, prindërit, por edhe vetë nxënësit (Montalvo & Torres, 2004).Ka qëndrime që mohojnë efektivitetin e tyre në rezultatet e nxënësit dhe nga ana tjetër ato që pohojnë ndikimin pozitiv të tyre në të nxënit dhe formimin e nxënësve. Sipas Rooney nëse ato për nxënësit janë shfrytëzuese të kohës së tyre të lirë dhe për prindërit burim ankthi dhe përgjegjësie të papërballueshme, pse duhet t'u jepen detyra nxënësve në shtëpi edhe nëse ato janë të dobishme, atëherë si do të jepen dhe si duhen menagjuar ato për të kryer me sukses rolin e tyre dhe për të plotësuar synimin e dhënies së tyre (Rooney, 2008). Harry Cooper, në librin e tij “Beteja mbi detyrat e shtëpisë” (Battle over Homework) detyrat e shtëpisë i përkufizon si detyra që u jepen nxënësve nga mësuesit për t'u kryer pas mësimit në shtëpi apo në një mjedis tjetër (Patton, 2002).Gjatë vitit shkollor prindërit e fëmijëve të arsimit fillor i shohin detyrat si aspektin ku mund të vëzhgojnë dhe njihen me përparimin e fëmijës së tyre. Mësuesit mendojnë se ato janë përcaktuese në rezultatet e fëmijëve në mësim, prandaj ata bëjnë kujdes që plotësimi i tyre të kryheta më mirë(Hoover-Dempsey et.al , 1995). Mësimdhënësit mund të mbështesin gjithashtu vetëdijen e prindërve edhe pas shkollës për strategjitë e drejtpërdrejta të mësimdhënies që mund të jenë të dobishme për të ndihmuar nxënësit me detyrat e shtëpisë.Prindërit mund të përfitojnë gjithashtu duke ditur se strategjitë e drejtpërdrejta të mësimdhënies shpesh janë më të përshtatshme për nxënësit që janë më të rinj, kanë vështirësi në punë ose kërkojnë ndihmë.Sugjerime për sasinë e mësimit të drejtpërdrejtë që është i përshtatshëm për nxënës në nivele të ndryshme të zhvillimit dhe të notave mund të jenë veçanërisht të dobishme, siç janë sugjerimet për aktivitete mësimore që plotësojnë nevojat individuale të nxënësve (Cunha et.al, 2015).

## 2.2. “Me apo pa detyra të shtëpisë”

“Me apo pa detyra të shtëpisë?” – Është kjo pyetja që trumbetohet edhe në rrafshin ndërkombëtar e që ka nxitur debat e qindra përpyetje për të ofruar argumente karshi përgjigjeve të mundshme, nëpër periudha të ndryshme kohore kudo në sistemet arsimore që synojnë avancimin e cilësisë. Nismat për të ndryshuar përmbajtjen e detyrave të shtëpisë apo edhe për të ofruar sa më pak detyra është mirëpritur nga fëmijët, si dhe nga prindërit, të cilët në raste jo të pakta nuk mund të asistojnë fëmijët e tyre në shtëpi, gjatë kryerjes së detyrave. Angazhimi në detyrat e shtëpisë është parë nga këndvështrimi poliedrik nëpër kohë, duke vënë në pah rëndësinë që kanë detyrat e shtëpisë në angazhimin e prindërve dhe informimin e tyre për progresin e fëmijës si dhe për punën që bëhet në shkollë.

Ekzistojnë studime të shumta (Eccles & Harold, 1993), (Cooper, Robinson, & Patall, 2006), (Coutts, 2004), (Deslandes, 2009), (Warton, 2001), (Valle et.al, 2016) që provojnë të vënë në pah ndikimin që kanë detyrat e shtëpisë në mësimnxënie, duke nxjerrë argumente se si detyrat e shtëpisë i ndihmojnë nxënësit që të arrijnë në rezultate më të mira. Por edhe disa nga hulumtimet arsimore (Kohn, 2007) treguan se detyrat e shtëpisë kanë pak ndikim dhe se ato mund të shkaktojnë stres për fëmijët dhe nuk vlerësohen gjithmonë.

Kur është fjala të mësimdhënësit shihet si shumë me rëndësi mënyra e përpilimit si dhe qëllimi i delegimit të detyrave të shtëpisë (Epstein&Voorhis, 2001) nga ana e tij (Cooper & Valentine, 2001).Ndërsa nga literatura ekzistuese del në pah se edhe vetë perceptimi i nxënësve për detyrat e shtëpisë dhe efektivitetin e tyre determinohet nga mësimdhënësit e tyre, varësisht nëse përzgjedhjen e detyrave që ua delegojnë ëshë në përputhje me nevojat dhe interesin e nxënësve në klasë

Në Kosovë detyrat e shtëpisë delegoheshin gjithmonë edhe për faktin që koha e paktë që kishin mësimdhënësit në dispozicion brenda një ore mësimore dhe numri i madh i nxënësve në klasë, bëri që gjithnjë t’u ipen nxënësve një pjesë e madhe e detyrave për t’i kryer në shtëpitë e tyre. Pavarësisht polemikave në këtë drejtim, mësimdhënësit në Kosovë vazhdojnë akoma të japin si obligim bërjen e detyrave të shtëpisë.

Nëse puna e pavarur dhe detyrat e shtëpisë janë të hartuara dhe të mbikqyrura, që të dyja mund t’i ndihmojnë nxënësit të zotërojnë objektiva të të gjitha niveleve, nga aftësia e thjeshtë dhe praktika e njohurive, deri tek vlerësimet e kujdesshme të ideve komplekse. Detyrat e shtëpisë parashihen

edhe ne Kurrikulën e Kosovës (MASHT, 2016) ku janë të domosdoshme dhe te nevojshme për vlerësimin e nxënësve. Ato hynë edhe në vlerësimin formativ në nivel të klasës që realizohet në mënyrë të vazhdueshme gjatë gjithë vitit mësimor nëpërmjet angazhimit të nxënësve edhe në shtëpi. Ditari personal i mësimit për vlerësimin e nxënësve sipas kurrikulës kombëtare është bërë kusht i domosdoshëm. Ky ditar shërben për rezultatet e vlerësimit formativ në nivelin e arritjes së rezultateve të të nxënësve (Murchan, Sheil, & Vula, 2011), ku përpos instrumenteve tjera vlerësuese detyrat e shtëpisë edhe këtu zënë vend të rëndësishëm. Sipas Kornizës Kurrikulare të Kosovës (MASHT, 2016) tek kompetenca e të menduarit-mendimtar kreativ, detyrat e shtëpisë ndihmojnë nxënësin gjatë punës së pavarur si në klasë sikurse edhe në shtëpi, duke sjellur sa më shumë shembuj edhe nga jeta e përditshme, duke përdorur imagjinatën e duke e lidhur me materialin e dhënë nga mësimit.

### 2.3. Teoritë për përfshirjen e prindërve në detyrat e shtëpisë

Mbështetur në teorinë e modelit bioekologjik të Brofenbrennerit (1986), por edhe në rezultatet psikologjike dhe sociale, studiusit Hoover-Dempsey dhe Sandler (Hoover, Dempsey & Sandler, 1995) prezantuan një teori, ku shpjegojnë në mënyrë të detajuar, se çfarë i motivon prindërit për t'u përfshirë në edukimin duke renditur disa arsye madhore, të cilat janë:

- Ndërtimi i rolit personal prindëror për t'u transmetuar fëmijëve një model prindërimi;
- Për të rriturit ndjesinë e zotësisë së tyre si prindër me qëllim që t'i ndihmojë fëmijët të kenë sukses në shkollë;
- Reagimin e tyre përkundrejt mundësisë që u japin si fëmijët, ashtu dhe shkollat e tyre për t'u përfshirë në jetën e shkollore;
- Konteksti i jetës së prindërve (Hoover, Dempsey & Sandler, 1995).

Puna studimore për të dhënë një kornizë teorike që do të unifikohen dhe gjetjet e studimeve, ka filluar që në vitin 1987, kur studiuesja Epstein indifikoi katër tipe të përfshirjes prindërore: a). obligimet bazë, b). komunikime shkollën c). përfshirjen e prindërve në shkollë dhe d) përfshirja e prindërve në aktivitetet e të nxënies në shtëpi, kornizë e cila u përmirësua nga autorja në vitin 1995, duke shtruar e zgjeruar edhe me dy tipe të tjera (Epstein, 2001).

**Tabela 1. Tipologjia e Epstein për përfshirjen prindërore në shkollë.**

Tipet	Përshkrimi i tipit	Shembuj
Tipi 1	Obligimet bazë të familjes	Sigurimi i nevojave bazë të familjes siç janë shëndeti dhe siguria
Tipi 2	Obligimet bazë të shkollës	Komunikimi midis shkollës dhe familjes siç janë memot, telefonat, lista e notave dhe takimet
Tipi 3	Përfshirja në shkollë	Puna vullnetare në shkollë për të mësuesin në klasë ose pjesmarrje në aktivitetet e shkollës

Tipi 4	Përfshirja në veprimtaritë e të nxënit në shtëpi	Ndihma e fëmijëve në detyrat e shtëpisë
Tipi 5	Përfshirja e prindërve në vendimarrje dhe qeverisjen e shkollës	Dhënia e kontributit në një organizatë prind-mësues ose këshill, bord ose ndonjë pozicion tjetër drejtues
Tipi 6	Bashkëpunimi i ndërsjellt me organizatat e komunitetit	Realizimi i lidhjes me organizata që kanë në fokus edukimin e fëmijëve, si programes pas-shkollore.

#### 2.4. Niveli i përfshirjes së prindërve në realizimin e detyrave të shtëpisë

Kërkimet shkencore por edhe praktika shkollore tregojnë se shkolla efektive janë ato që komunikojnë në mënyrë të vazhdueshme me prindërit. Në këto shkolla prindërit shihen si pjesëmarrës në procesin mësimor. Mësuesit i informojnë ata rreth aktiviteteve të klasës përmes procedurave të komunikimit të dyanshëm. Bashkëpunimi me prindër në forcimin e rolit edukativo-arsimor të shkollës, si dhe në ngritjen e efikasitetit të plotë të punës mësimore, luan rol me rëndësi në këtë drejtim. Programet që ndihmojnë prindërit të angazhohen në këtë përfshirjeje mund të ofrojnë demonstrata të aktiviteteve mësimore të përshtatshme zhvillimore, mundësitë për praktikë të strategjive të ndryshme dhe informacion rreth vlerësimit të përparimit të nxënësve (Starkey & Klein, 2000). Efektet pozitive dhe negative shfaqen njëherazi, të pandara dhe të ndërthurura me njëra - tjetrën. Në këtë mënyrë nëse një detyrë shtëpie mund të përmirësojë shprehitë e të nxënit, në të njëjtën kohë ajo privon fëmijën nga aktivitete të tjera që mund të zhvillonte gjatë kohës së lirë (MASHT, 2016).

Edhe (Eccles & Harold, 1993) përcaktuan besimet e efikasitetit të prindërve të përbëra nga tre variabla: "Besimi i prindërve që ata mund t'i ndihmojnë fëmijët e tyre me punë në shkollë" (fq 572), pikëpamjet e prindërve për kompetencat e tyre dhe bindjet e prindërve që ata mund të ndikojnë në shkollë përmes ndihmës që mund të ofrojnë në menaxhim të shkollës.

Përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë së fëmijëve duket të ndikojë në rezultatet e nxënësve, sepse ofron modele, përf forcime dhe udhëzime që mbështesin zhvillimin e qëndrimeve, njohurive

dhe sjelljeve të lidhura me performancën e suksesshme të shkollës (Hoover et. al, 1995). Sipas (Haliti, 2007), ndihma e prindërve nuk guxon të konsistojë në kryerjen e detyrave. Sipas tij, ndihma duhet reflektojë në të siguarit e kushteve si dhoma e posaçme e punës, tavolina e karriga e punës, vitrina, veglat e punës, tekstet, shtypi për fëmijë e kështu me radhë. Pastaj, t'i kontrollojnë, mbikëqyrin, udhëzojnë si dhe t'ua caktojnë terminin brenda ditës për kryerjen e detyrave.

Sipas një studimi të bërë nga (Pupovci & Tafarshiku, 2008) rreth pjesëmarrjes së prindërve në jetën e shkollës në Kosovë, ku janë përfshirë 41.5% të shkollave fillore të Kosovës, ku mësojnë 44.6% të nxënësve dhe punojnë 42.2% të mësimdhënësve, tregon se komunikimi individual me prindër është çelësi i përfshirjes së tyre në jetën e shkollës. Sipas rezultateve të sondazhit ky komunikim, kryesisht zhvillohet në kahun "shkollë-prind", ku prindi ka më shumë mundësi për të dëgjuar sesa për të shprehur qëndrimin e vet. Vet shembulli se 50% të shkollave të anketuara nuk bëjnë sondazhe që të kuptojnë opinionet/qëndrimet e prindërve flet për mundësinë shumë të kufizuar të prindërve që me qëndrimin e tyre individual të ndikojnë në përmirësimin e situatës në shkollë. Kohët e fundit përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë së nxënësve po merr çdo ditë e më shumë vëmendjen e studiuesve.

Përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë është një konstrukt multikomponental që përfshin të dy aspektet sasiore dhe cilësore duke filluar nga përkrahja konkrete deri të udhëzimet me komplekse. Megjithatë lidhjet në mes përfshirjes së prindërve në detyrat e shtëpisë dhe performancës së nxënësve si dhe arritjeve të tyre në rezultate nuk gjenden vazhdimisht në literaturën empirike. Sipas (Epstein & Voorhis, 2001), detyrat e shtëpisë mund të hartohen qëllimisht nga mësuesi që t'i informojë ose përfshijë të gjithë anëtarët e familjes së nxënësve në aktivitete kurrikulare.

Kur është fjala te mësimdhënësit shihet si shumë me rëndësi mënyra e përpilimit si dhe qëllimi i delegimit të detyrave të shtëpisë, nga ana e tij (Cooper & Valentine, 2001). Ndërsa nga literatura ekzistuese del në pah se edhe vetë perceptimi i nxënësve për detyrat e shtëpisë dhe efektivitetin e tyre determinohet nga mësimdhënësit e tyre, varësisht nëse përzgjedhjen e detyrave që ua delegojnë ëshë në përputhje me nevojat dhe interesin e nxënësve në klasë. Mësuesit mund të zbatojnë procedura që t'i mbajnë familjarët të informuar për atë që fëmijët kanë mësuar në klasë, si të mbështesin punën dhe avancimin e fëmijëve, dhe si të krijojnë lidhje me mësuesit. Disa detyra mund të dizajnohen për prindërit që t'i japin ndihmë shtesë fëmijëve me dobësi specifike. Këto

detyra kërkojnë që mësuesit të ofrojnë udhëzime të qarta në trajnime që prindërit të kenë sukses në rolin e tyre si “mbikëqyrës”. Mësuesit, mund të hartojnë detyra të shtëpisë që inkurajojnë nxënësit për të bashkëbiseduar me partnerët familjar për ti kompletuar detyrat.

## **2.5. Detyrimet e rolit prindëror në zhvillimin e fëmijës**

Ndërtimi i rolit prindëror ka një rëndësi të veçantë, pasi prej tij varen vendimet se cili prej aktiviteteve prindërore konsiderohet i nevojshëm kur bëhet fjalë për të ndërvepruar me fëmijën. Ky rol ndikon për të krijuar një këndvështrim të qartë për zhvillimin e fëmijës, për mënyrën e rritjes dhe për ndihmën që i duhet dhënë atij. Prindërit vështirë se përfshihen në edukim nëse ata besojnë se mësimdhënia u duhet lënë mësuesve, apo se adoleshenti është i pari që ka përgjegjësi mbi edukimin e vet. Përdorimi i teorisë së roleve si zgjedhje për edukimin e fëmijës i bën prindërit, të cilët sigurisht që u përkasin grupeve të ndryshme, të kenë edhe pritshmëri të ndryshme në lidhje me sjelljet e përshtatshme përfshi këtu edhe përfshirjen prindërore në edukim (Hoover-Dempsey & Sandler, 1995). Nëse shkollat presin që prindërit të jenë pak të përfshirë, ata nuk janë të prirur për t'u përfshirë. Besimet prindërore rreth zhvillimit dhe rritjes së fëmijës janë të lidhura me besimet, vlerat, qëllimet dhe dijen si dhe me një sërë sjelljesh prindërore që lidhen pikërisht me këta faktorë. Nëse prindërit, për shembull, mendojnë së fëmija ka nevojë për afeksion dhe për drejtim, ata shqyrtojnë vendimet që duhet të marrin në përshtatje me qëllimet edukative dhe zhvillojnë aftësinë për të bashkëbiseduar me fëmijët dhe ndjekin përparimin e tyre në shkollë (Deslandes, 2001).



## 2.6. Mundësitë dhe kërkesat për përfshirje nga fëmija dhe shkolla

Perceptimi për rolin prindëror, si dhe ndjenja e të qenit i zoti për të ndihmuar fëmijën, përbëjnë dy faktorë shumë të rëndësishëm të cilët ndikojnë në vendimet e prindërve për të qenë pjesë e edukimit të fëmijës, por po kaq e rëndësishme është edhe kërkesa e fëmijëve dhe e shkollës. Kjo thirrje për pjesëmarrje apo ftesë, është vendimtare për mënyrën se si do të pozicionohet prindi. Këto nevoja që ka shkolla dhe mundësitë që ajo ofron për të përfshirë në edukim prindërit e fëmijëve, nëse karakterizohen nga pozitiviteti dhe energjia mund të shërbejnë si burime besimi për efektivitetin prindëror. Nga ana tjetër nuk mjafton thjesht një ftesë ose kërkesë që prindërit të hidhen në veprimin e përfshirjes, por duhet pa tjetër që kjo veprimtari të drejtohet dhe të inkurajohet (Hoover-Dempsey & Sandler, 1995). Kërkesat që vijnë nga fëmijët dhe shkolla për të pasur mbështetjen dhe prezencën e prindërve, mund të quhen edhe si kërkesa të përgjithshme. Kur fëmijët p.sh shfaqin entuziazëm të vazhdueshëm kur prindërit e tyre vizitojnë shkollën, apo kur tregohen të etur për të folur me prindërit e tyre për atë se çka ndodh në shkollë. Kjo, për prindërit perceptohet si nevojë dhe domosdoshmëri e fëmijës që ata si prindër duhet të plotësojnë, me përfshirjen e tyre në këto veprimtari kaq të rëndësishme për fëmijën e tyre. Nga ana tjetër, sinjalin për ftesën e shkollës prindi e merr përmes ndjesisë së të qenit i mirëpritur në mënyrë të vazhdueshme, në një mjedis miqësor (ku mësuesit p.sh përshëndeten me prindërit në koridore), përmes njoftimeve të vazhdueshme të shkollës që kërkojnë që prindërit të bëjnë punë vullnetare për shkollën apo të marrin pjesë në veprimtari të ndryshme të organizuar nga shkolla (Hoover-Dempsey & Sandler, 1997). Megjithëse këto mundësi të përgjithshme të ofruara si nga fëmijët ashtu edhe nga shkolla janë shumë të rëndësishme, ato janë të nevojshme por jo të mjaftueshme për të bërë që prindërit të jenë të përfshirë në edukimin e fëmijëve. (Hoover-Dempsey, et al., 2005) merren me ata prindër që në perceptimin e tyre mbi rolin prindëror e shohin përfshirjen prindërore si detyrim, dhe që ndihen të zotë për të ndihmuar fëmijët për të pasur sukses në detyrat shkollë. Këta prindër sipas tyre, do të përfshihen në edukimin e fëmijëve pavarësisht nëse fëmijët apo edhe vetë shkollat i ftojnë për ta bashkëpunuar ose jo. Po kështu shpjegojnë studiuesit se ndodh edhe me prindërit, të cilët nuk e mendojnë përfshirjen e tyre si të rëndësishme që kur perceptojnë rolin e tyre prindëror, por edhe me ata prindër të cilët nuk e shohin veten të zotët për të ndihmuar fëmijët e tyre në detyrat shkollë. Me këta prindër duhet punuar në mënyrë të veçantë nga specialistët (mësuesit, drejtuesit, psikologët shkollor) sipas këtyre studiuesve, duke bërë përpjekje për t'i bindur gojarisht për rëndësinë dhe fuqinë që ata disponojnë që me punën e tyre me fëmijën të

mundësojnë suksesin shkollor. Kjo përvojë ndryshon për mendimet e krijuara nga përvojat e mëparshme dhe ndikon që prindërit të ndryshojnë qëndrimet e tyre për rolin prindëror por edhe për vetë-efikasitetin e tyre.

## 2.7. Detyrat e shtëpisë në shkollën fillore

Megjithëse detyrat e shtëpisë ndihmojnë në përvetësimin dhe përforsimin e njësisë së zhvilluar në klasë, në momentin e dhënies së detyrave nga ana e mësimitdhënësit, duhet të merret parasysh sasia dhe cilësia e detyrave të cilat u jepen nxënësve, ngase në të kundërtën detyrat e shtëpisë e humbin efektin e tyre, pasi që jo të gjithë nxënësit kanë aftësitë e njëjta për ti kuptuar e deri tek zgjidhja e tyre.

Sipas KKK-ës ( në shkallën 1 përfshihen klasat I dhe II) dhe qëllimi kryesor është përvetësimi themelor i njohurive nga nxënësit.


Ndërsa në shkallën 2 përfshihen klasat ( III-V) ku qëllimi kryesor është përforsimi dhe zhvillimi i nxënësve.

**Tabela 2. Struktura e sistemit të arsimit para universitar sipas KKK-së**

KSNA 1	Arsimi fillor Klasat I-V	Shkalla 2: Përforsim dhe zhvillim- klasat III-V  Shkalla 1	Kurrikula Bërthamë për klasën përgatitore dhe arsimin fillor
KSNA 0	Klasa përgatitore	Përvetësim themelor-klasa përgatitore, klasat I dhe II	Kurrikula Bërthamë për edukimin në fëmijërinë e hershme
	Edukimi parashkollor	Shkalla përgatitore e Kurrikulës: Edukimi në fëmijërinë e hershme	

Në shumicën e rasteve shohim se tekstet e nxënësve të shkollës fillore janë të mbingarkuara dhe të pa përshtatshme për moshën e nxënësve dhe është e domosdoshme përfshirja e prindërve për të ndihmuar rreth detyrave. Më së miri e tregon këtë detyra në vijim e cila është dhënë në klasën e dytë në lëndën e Gjuhës shqipe të autorëve Rrahman Paçarizi, Saranda Kumnova Pozhegu dhe Aurela Zisi(2019), shihet qartë se është shumë e vështirë të kuptohet pa ndihmën e prindit, në klasën e dytë parashihet që vetëm të kemi përvetësim themelor të njohurive, në detyrën në vijim

kërkohet të shkruhet një tregim nga vetë nxënësit e që kjo detyrë është mbingarkesë për nxënësit dhe e papërshtatshme për moshën e tyre.



## 2.8. Rëndësia e partneritetit shkollë – familje

Të shumta janë studimet të cilat tregojnë se nga bashkëpunimi shkollë-familje është dëshmuar se përfitues janë nxënësit, shkolla përforcohet dhe ndihmohen mësuesit, përforcohen dhe familjet (Epstein, 2001).

Shkolla dhe familja ndajnë misionin e tyre thelbësor për edukimin dhe arsimimin e brezit të ri. Bashkëpunimi shkollë-familje mund të ketë ndikim pozitiv dhe ndikim negativ, është pozitiv atëherë kur bashkëpunimi është i hapur, i sinqertë dhe i përgjegjshëm, ndërsa është negativ atëherë kur mungon komunikimi, mirëkuptimi dhe ndihma reciproke. Kur fëmija fillon klasën e parë, prindërit janë të interesuar për mësimdhënësin e fëmijës së tyre, organizimin e shkollës, orarin mësimor, arritjet e fëmijëve të tyre etj., ndërsa në anën tjetër shkolla përkatësisht mësimdhënësit duan të dinë për personalitetin e fëmijës, përparësitë dhe vështirësitë në të nxënë etj., pra ka rëndësi informimi reciprok për fëmijën (nxënësin), përmes bashkëpunimit shkollë - familje, krijohet partneritet ndërveprimi, këmbimi i informatave e përvojave si dhe vendimmarrja e përbashkët. Po ashtu nga shkalla dhe cilësia e bashkëpunimit të faktorëve shkollë-familje, fitohen informata më të plota dhe më të thella për personalitetin e fëmijës (nxënësit). Bashkëpunimi i mirëfilltë i faktorëve shkollë - familje përmirëson dhe avancoon marrëdhëniet në shkollë, në familje dhe në komunitet, thellon bashkëpunimin në mes të faktorëve shkollë - familje, ngrit vetëdijen për aftësim dhe hulumtim të vazhdueshëm psiko-pedagogjik, reflekton në harmonizimin e realizimit të qëllimit edukativ (ZUNA & bashkautorët, 2009). Sot, studiuesit, edukatorët dhe prindërit theksojnë një histori të pasur nga puna e përbashkët e shkollës dhe familjes dhe bëjnë thirrje për përfshirje më të madhe të prindërve në edukim. Përfshirja e prindërve në studime të ndryshme

është përkufizuar si përfaqësuese e sjelljeve dhe praktikave në shkollë ose në shtëpi që përfshijnë aspiratat e prindërve, pritshmëritë, qëndrimet dhe besimet e prindërve në lidhje me edukimin e fëmijëve (Georgiou & Tourva, 2007)). Prindërit gjithashtu luajnë një rol të rëndësishëm në strukturimin e qëllimeve të arsimit për fëmijët e tyre. Ata janë më familjarët me personalitetin, kapacitetet, vështirësitë dhe aktivitetet e favorizuara të fëmijëve të tyre(OECD, 2007).

### III. METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Për të kryer hulumtimin mbi nivelin e përfshirjes së prindërve në detyrat e shtëpisë tek nxënësit e shkollës fillore është shfytëzuar *metoda e përzier*, konkretisht, metoda cilësore dhe sasiore. Metodatat që janë përdorur në këtë studim janë në funksion të realizimit të qëllimit të hulumtimit.

Përmes metodës cilësore (kualitative) janë mbledhur të dhënat cilësore të mësimdhënësve, nëpërmjet intervistimit, me intervista të gjysmë të strukturuar, për të kuptuar më thellësisht qëndrimet e mësimdhënësve lidhur me përfshirjen e prindërve në detyrat e shtëpisë në shkallën e dytë të kurrikulës.

Ndërsa përmes metodës sasiore (kuantitative) janë mbledhur të dhënat sasiore duke përdorur pyetësoin për prindër dhe nxënës. Të dhënat sasiore kanë mundësuar të njohim dhe të dijme nivelin e përfshirjes së prindërve në detyra të shtëpisë te nxënësit e shkollës fillore.

#### ***3.1. Mostra / Populacioni / Pjesëmarrësit***

Popullacioni i këtij studimi e përfshijë të gjithë prindërit, mësimdhënësit dhe nxënësit e Republikës së Kosovës. Meqë ky numër është shumë i madh dhe i pacaktuar, është përzgjedhur një grup i studimit dhe këtë hulumtim përbëjnë prindërit, mësimdhënësit dhe nxënësit e dy shkollave të komunës së Prishtinës dhe katër shkolla të komunës së Vushtrrisë. Zgjedhja e kampionit është bërë *me zgjedhje të thjeshtë rastësore*, një teknikë që siguron se çdo element në popullatë ka një shans të barabartë për t'u zgjedhur në kampion.

Si mostër të hulumtimit janë marrë 8 mësimdhënës, 50 prindër dhe 50 nxënës të shkallës së dytë të kurrikulës të arsimit fillor nga këto komuna.

Në komunën e Prishtinës hulumtimi është realizuar në shkollat “Azemi e Salihu” dhe “Dëshmorët e 19121”, në komunën e Vushtrisë hulumtimi është realizuar në shkollën: “Andon Zako Çajupi”, në shkollën “Naim Frashëri”, në shkollën “Ali Kelmendi” dhe në shkollën “Mustafë Venhari”.

## Të dhënat demografike të prindërve

### Gjinia

	Frekuenca	Përqindja
Mashkull	13	26
Femër	37	74
Gjithsej:	50	100.0

Tabela 3. Të dhënat për gjininë e prindërve

Në tabelën e pestë është paraqitur gjinia e prindërve pjesëmarrës në hulumtim, ku kemi 13(26%) meshkuj dhe 37(74%) femra dhe këto në total bëjnë 50 pjesëmarrës në hulumtim.

### Mosha

	Frekuenca	Përqindja
Më pak se 25	6	12
25-29	12	24
30-39	10	20
40-49	13	26
50-59	9	18
Gjithsej:	50	100.0

Tabela 4. Të dhënat për moshën e prindërve

Në tabelën e gjashtë është paraqitur mosha e prindërve pjesëmarrës në hulumtim, ku kemi 6 (12%) pjesëmarrës që kanë më pak se 25 vjet, 12(24%) pjesëmarrës që i takojnë moshës 25-29, 10(20%) që i takojnë moshës 30-39 vjet, 13(26%) pjesëmarrës që i takojnë moshës 40-49,9(18%) pjesëmarrës që i takojnë moshës 50-59 dhe që këto në total bëjnë 50 pjesëmarrës.

### Niveli më i lartë i edukimit tuaj

	Frekuenca	Përqindja
Shkollë fillore	11	22
Shkollë e mesme	17	34
Fakultet	16	32
Master	6	12
Tjetër	0	0
Gjithsej:	50	100.0

Tabela 5 . Të dhënat për nivelin e edukimit të prindërve

Në tabelën e shtatë është paraqitur niveli i edukimit të prindërve, ku 11 (22%) e pjesëmarrësve kanë të përfunduar shkollën fillore, 17 (34%) e pjesëmarrësve kanë të përfunduar shkollën e mesme, 16 (32%) e pjesëmarrësve kanë të përfunduar nivelin e Fakultetit, 6 (12%) e pjesëmarrësve kanë të përfunduar nivelin Master, 0 (0%) e pjesëmarrësve kanë të kryer nivelin tjetër të shkollimit dhe këto në total bëjnë 50 pjesëmarrës.

### 3.2. Modeli dhe metodat e mbledhjes së të dhënave

Modeli i studimit është *përfaqësues*, ku është bërë përshkrimi i perceptimeve të prindërve, mësimdhënësve dhe nxënësve për përfshirjen e prindërve në relizimin e detyrave të shtëpisë në shkollën fillore në shkallën e dytë të kurikulës.

Si metodë e mbledhjes së të dhënave, është shfrytëzuar *metoda e përzier*, konkretisht, kombinimi i metodës sasiore dhe cilësore, ku metoda sasiore e hulumtimit ka të bëjë me mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave që janë të strukturuar dhe që mund të paraqiten në formë numerike, ndërsa metoda cilësore ka të dhëna të mbledhura si fjalë dhe shprehje të vet pjesëmarrësve në hulumtim (Matthews & Ross, 2010). Metodatat që janë përdorur në këtë studim ishin në funksion të realizimit të qëllimit të hulumtimit.

### **3.3.Instrumentet e mbledhjes së të dhënave**

Instrumentet për mbledhjen e të dhënave janë pyetësi për prindër dhe nxënës dhe intervista me mësimdhënës.

Përmes instrumentit të pyetësit janë mbledhur perceptimet që prindërit dhe nxënësit kanë për përfshirjen në detyrat e shtëpisë. Janë hartuar pyetësor të standardizuar (duke kërkuar nga pjesëmarrësit të rrethojnë përgjigjen që u duket më e drejtë). Është përdorur pyetësi për prindër dhe nxënës me qëllim të grumbullimit të të dhënave statistikore dhe intervistë me mësimdhënës me qëllim të grumbullimit të të dhënave cilësore. Hulumtimi është zhvilluar përmes dy pyetësorëve të hartuar sipas shkallës së Likerit dhe përmes intervistës gjysëm të strukturuar.

Pra pasur parasysh qëllimin e hulumtimit, dhe për të adresuar pyetjet kryesore të hulumtimit mjeti më i mirë është konsideruar edhe intervista me mësimdhënës. Siç sugjeron (Patton, 2002), intervista bën të mundur "të futemi në perspektivën e personit tjetër ... Intervistojmë për të gjetur se çfarë është në mendjen e dikujt tjetër ..."

Intervistimi i mësimdhënësve ka filluar me një përshkrim dhe informata të detajuara rreth idesë së hulumtimit, dhe është vazhuar duke ua bërë të ditur pjesëmarrësve se të gjitha të dhënat do të analizohen duke pasur parasysh parimet etike dhe profesionale.



### 3.4. ANALIZA E TË DHËNAVE

Analiza e rezultateve të të dhënave dhe interpretimi i tyre është bërë në bazë të pyetësorit (të dhëna sasiore) me prindër dhe nxënës . Rezultatet janë paraqitur me anë të grafikëve të punuar në programin statistikor për shkencat sociale SPSS, versioni i 26 -të, të shprehura në përqindje (%). Të dhënat cilësore janë punuar përmes analizës tematike, ku është bërë përcaktimi i temave kryesore, më pas interpretimet fillestare dhe vendosja e tyre në kategori përkatëse, që i korrespondojnë hulumtimit.

Në bazë të rezultateve të fituara përmes përgjigjeve të dhëna nga prindërit, nxënësit dhe mësimdhënësit kemi vërejtur se cilat janë perceptimet e prindërve, nxënësve dhe mësimdhënësvë me qëllim që ato të sjellin rezultate të mira në perfshirjen e prindërve në detyra të shtëpisë.

#### 3.4.1. Të dhënat demografike

		Gjinia	Mosha	Niveli më i lartë i edukimit tuaj
N	Valide:	50	50	50
	Mungojnë:	0	0	0
Mesatarja		1.2600	3.1400	2.3400
Mediana		1.0000	3.0000	2.0000
Moda		1.00	4.00	2.00
Devijimi standard		.44309	1.30946	.96065
Rangu		1.00	4.00	3.00
Minimumi		1.00	1.00	1.00
Maksimumi		2.00	5.00	4.00
Shuma		63.00	157.00	117.00

Tabela 6. Analiza demografike për pyetësorin e prindërve

Në këtë tabelë janë paraqitur statistikat përshkruese, ku fillimisht është paraqitur N- numri total i responentëve N=50, pastaj për secilën karakteristikë demografike është paraqitur mesatarja, mediana, moda, devijimi standard, rang, minimum, maksimumi dhe shuma e tyre.

### 3.4.2. Besueshmëria e instrumentit

Për zhvillimin e hulumtimit është e rëndësishme edhe besueshmëria e pyetësorve. Niveli i besueshmërisë përbëhet nga pyetësi i prindërve. Si mjet për vërtetimin e besueshmërisë është përdorur Cronbach's Alpha, e cila gjithashtu është e bazuar në pyetjet e standardizuara.

Analiza e besueshmerise		
Cronbach's Alpha	Cronbach's Alpha e bazuar ne pyetjet e standarizuara	Numri i pyetjeve
.774	.781	18

Tabela 7. Analiza e besueshmërisë për pyetësorët e prindërve


Rezultatet tregojnë se te pyetësi i prindërve sipas Cronbach's Alpha=.781, besueshmëria e pyetësorit është e kënaqshme, e pranueshme.

## IV. REZULTATET E HULUMTIMIT

Në këtë kapitull paraqiten të gjitha gjetjet e hulumtimit. Gjetjet janë organizuar sipas radhës së pyetjeve të studimit, së pari gjetjet nga pjesëmarrësit prindër, nxenes, pastaj ato nga mësimdhënësit, gjithashtu duke veçuar fillimisht të dhënat sasiore pastaj ato cilësore.

### 4.1. Të dhënat sasiore


*Rezultatet e paraqitura me anë të grafikëve (përceptimet e prindërve)*



Grafiku 1. *Unë çdo ditë pyes fëmijën tim për detyrat e shtëpisë.*


Në pyetjen e parë të hulumtimit qëllimi ka qenë të dihet se sa prindërit interesohen dhe pyesin fëmijët për detyrat e shtëpisë dhe për këtë në numër më të madh të respondentëve përkatësisht 52% e pjesëmarrësve janë përgjigjur me “Pajtohem”, e cila na tregon se prindërit e shohin të nevojshëm

ti pyesin femijët e tyre për detyrat e shtëpisë, pastaj 38% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem plotësisht”, ndërsa 10% qëndrojnë “Neutral”, ndërsa asnjëri nga respondentët nuk kundërshton këtë pohim, përkatësisht kemi 0% “Nuk pajtohem” dhe 0% “Nuk pajtohem aspak”.




Grafiku 2. Fëmija im ka çdo ditë detyra të shtëpisë.

Në pyetjen e dytë të hulumtimit qëllimi ka qenë të dihet se si shprehen prindërit se fëmijët e tyre kanë çdo ditë detyra të shtëpisë dhe si rezultat 46% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem plotësisht”, gjë e cila na tregon se rreth gjysma e respondentëve, pra prindërit e fëmijëve pajtohen plotësisht me pohimin e lartë cekur, pastaj 34% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem”, ndërsa 20% qëndrojnë “Neutral”, ndërsa asnjëri nga respondentët nuk ka qëndrim të kundërt me këtë pohim, përkatësisht 0% e tyre “Nuk pajtohem” dhe 0% e respondentëve përgjigjen me “Aspak nuk pajtohem”.




Grafiku 3. *Fëmija im është i ngarkuar me detyra të shtëpisë.*

Në pyetjen e tretë të hulumtimit qëllimi ka qenë të dihet se fëmija i tyre është i ngarkuar me detyra të shtëpisë, kjo dihet nga përgjigjet e respondentëve ku përkatësisht 32% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Nuk pajtohem aspak”, pastaj 20% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Nuk pajtohem”, ndërsa 16% e tyre qëndrojnë “Neutral”, 16% e tyre u përgjigjën me “Pajtohem” dhe 14% e tyre u përgjigjën me “Pajtohem plotësisht”.




Grafiku 4. *Fëmija im me dëshirë i kryen detyrat e shtëpisë.*

Në pyetjen e katërt të hulumtimit qëllimi ka qenë të dihet se si prindërit japin mendimin e tyre se fëmija i tyre me dëshirë i kryen detyrat e shtëpisë, nga përgjigjet e respondentëve shohim se në numër më të madh përkatësisht 34% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem”, që tregon se numri më i madh i prindërve tregojnë se fëmija i tyre me dëshirë i kryen detyrat e shtëpisë pastaj 24% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Nuk pajtohem”, ndërsa 16% e pjesëmarrësve qëndrojnë “Pajtohem plotësisht”, 14% e pjesëmarrësve përgjigjen me “Nuk pajtohem aspak” dhe 12% e tyre shprehen “Neutral”.



Grafiku 5. *Fëmijës tim çdo ditë ia kontrolloj detyrat e shtëpisë.*


Në pyetjen e pestë të hulumtimit qëllimi ka qenë të dihet se si prindërit deklarohen se çdo ditë fëmijës së tyre ia kontrollojnë detyrat e shtëpisë dhe për këtë në numër më të madh përkatësisht 74% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem plotësisht”, kjo tregon se prindërit çdo ditë ia kontrollojnë fëmijve detyrat e shtëpisë pastaj 26% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem”, ndërsa 9% e pjesëmarrësve qëndrojnë “Neutral”, 0% pjesëmarrësve u përgjigjën me “Nuk pajtohem” dhe 0% e tyre me “Nuk pajtohem aspak”.



Grafiku 6. Përafërishtë sa kohë brenda ditës i ndihmoni fëmijës rreth detyrave të shtëpisë?


Në pyetjen e gjashtë të hulumtimit se sa kohë brenda dites i ndihmojnë prindërit fëmijët rreth detyrave të shtëpisë në numër më të madh përkatësisht 40% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “30-40 min”, pastaj 32% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “10-20 min”, ndërsa 24% e pjesëmarrësve me “1-2 ore”, 4% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Nuk i ndihmoj”.






Grafiku 7. Cili nga prindërit ndihmon më shumë fëmijën rreth detyrave të shtëpisë?

Në pyetjen e shtatë të hulumtimit qëllimi ka qenë të dihet se cili nga prindërit ndihmon më shumë fëmijën rreth detyrave të shtëpisë, në numër më të madh përkatësisht 64% e pjesëmarrësve u përgjigjen me opsionin “Nena”, që do të thotë se më shumë se gjysma e prindërve deklarohen për nënën , pastaj 36% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Babai”.




Grafiku 8. *Fëmija im është i pavarur në kryerjen e detyrave të shtëpisë.*

Në pyetjen e tetë të hulumtimit qëllimi ka qenë të dihet se si mendojnë prindërit se fëmija i tyre është i pavarur në kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe 32% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem plotësisht”, pastaj 28% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem”, ndërsa 20% e pjesëmarrësve qëndrojnë “Neutral”, 12% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Nuk pajtohem aspak” dhe 8% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Nuk pajtohem”.




Grafiku 9. Gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë ju si prindër i referoheni:

Në pyetjen e nëntë të hulumtimit qëllimi ka qenë të dihet se prindërit gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë kujt i referohen, në numër më të madh përkatësisht 46% e pjesëmarrësve u përgjigjen “Tekstit mesimor”, që do të thotë se gjysma e prindërve pjesëmarrës i referohen vetëm tekstit mesimor, pastaj 24% e pjesëmarrësve u përgjigjen “Porosive te mesuesit”, 18% me “Pervojes tuaj” dhe 12% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Tjeter”.




Grafiku 10. Gjatë procesit të kryerjes së detyrave, ju si prindër në cilat faza keni vështirësi?

Në pyetjen e dhjetë të hulumtimit kërkohet të dihet se gjatë procesit të kryerjes së detyrave, prindërit në cilat faza kanë vështirësi, në numër më të madh përkatësisht 58% e pjesëmarrësve u përgjigjen “Në fazën e bindjes së fëmijës me rrugën e zgjidhjes”, pastaj 26% e pjesëmarrësve u përgjigjën “Në fazën e kryerjes së detyrave të shtëpisë”, ndërsa 16% deklarohen “Në fazën përgatitore”.



Grafiku 11. Cila është forma më e zakonshme e ndihmës që i ofroni fëmijës në detyra të shtëpisë?


Në pyetjen e njëmbëdhjetë të hulumtimit qëllimi ka qenë të dihet se cila është forma më e zakonshme e ndihmës që prindërit i ofrojnë fëmijës rreth detyrave të shtëpisë dhe për këtë në numër të madh përkatësisht 44% e pjesëmarrësve u përgjigjën “I jap sqarime”, pastaj 42% e pjesëmarrësve u përgjigjën “Vëzhgoj procesin e kryerjes së detyrave”, ndërsa 14% e tyre qëndrojnë me “I tregoj zgjidhjet dhe përgjigjet”.



**Përfshirjen tuaj në procesin e kryerjes së detyrave të shtëpisë në shtëpi e cilësoni si:**


Grafiku 12..Përfshirjen tuaj në procesin e kryerjes së detyrave të shtëpisë në shtëpi e cilësoni si:

Në pyetjen e dymbëdhjetë të hulumtimit qëllimi ishte të dihet se prinderit si e cilësojnë përfshirjen e tyre në procesin e kryerjes së detyrave të shtëpisë dhe për këtë në numër më të madh përkatësisht 56% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Perkrahe”, pastaj 24% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pengese per pune te pavarur”, ndërsa 20% e prindërve pjesëmarrës e konsiderojnë si “Zgjidhje”.



Grafiku 13. *Bashkëpunimi mësues- prind rreth detyrave të shtëpisë ndikon në arritjen e rezultateve të të nxënit.*


Në pyetjen e trembëdhjetë të hulumtimit qëllimi ishte të dihet çfarë mendojnë prindërit që bashkëpunimi mesues – prind rreth detyrave të shtëpisë ndikon në arritjen e rezultateve të të nxënit dhe për këtë në numër më të madh përkatësisht 84% e prindërve pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem plotësisht”, rezultat ky që tregon se bashkëpunimi mesues – prind rreth detyrave të shtëpisë ndikon shumë në arritjen e rezultateve të të nxënit pastaj 16% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem”, ndërsa 0% e pjesëmarrësve qëndrojnë “Neutral”, 0% e pjesëmarrësve përgjigjen me “Nuk pajtohem” dhe 0% e pjesëmarrësve përgjigjen me “Nuk pajtohem aspak”.



Grafiku 14. *Përfshirja e prindërve në detyra të shtëpisë ndikon në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies.*

Në pyetjen e katërmbëdhjetë të hulumtimit qëllimi ishte të dihet se prindërit si mendojnë që përfshirja e tyre ndikon në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies dhe për këtë në numër më të madh përkatësisht 86% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem plotësisht”, pastaj 14% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem”, ndërsa 0% e pjesëmarrësve qëndrojnë “Neutral” ndaj kësaj pyetje, 0% e pjesëmarrësve përgjigjen me “Nuk pajtohem” dhe 0% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Nuk pajtohem aspak” dhe ky rezultat na tregon se përfshirja e prindërve në detyra të shtëpisë ndikon në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies.






Grafiku 15..*Detyrat e shtëpisë ndikojnë në zhvillimin e të menduarit kritik.*


Në pyetjen e pesëmbëdhjetë të hulumtimit qëllimi ishte të dihet se çfarë mendojnë prindërit për pyetjen se detyrat e shtëpisë ndikojnë në zhvillimin e të menduarit kritik dhe në numër më të madh përkatësisht 60% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem plotësisht”, pastaj 24% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem”, ndërsa 16% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Neutral”.

Rezultatet e paraqitura me anë të grafikëve (përceptimet e nxënësve)




Grafiku 16. Unë çdo ditë në secilën lëndë, sipas orarit mësimor kam detyra të shtëpisë.

Në pyetjen e gjashtëmbëdhjetë të hulumtimit qëllimi ishte të dihet se nxënësit si tregojnë që ata çdo ditë në secilën lëndë, sipas orarit mësimor kanë detyra të shtëpisë dhe për këtë në numër më të madh përkatësisht 56% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem plotësisht”, pastaj 30% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem”, ndërsa 14% e pjesëmarrësve qëndrojnë “Neutral” ndaj kësaj pyetje, 0% e pjesëmarrësve përgjigjen me “Nuk pajtohem” dhe 0% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Nuk pajtohem aspak”.




Grafiku 17. Çdo ditë prindërit më pyesin për detyrat e shtëpisë.

Në pyetjen e shtatembëdhjetë të hulumtimit qëllimi ishte të dihet se si deklarohen nxenesit se çdo ditë prindërit i pyesin për detyrat e shtëpisë dhe për këtë në numër më të madh përkatësisht 52% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem”, pastaj 26% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem plotësisht”, ndërsa 22% e pjesëmarrësve qëndrojnë “Neutral” ndaj kësaj pyetje, 0% e pjesëmarrësve përgjigjen me “Nuk pajtohem” dhe 0% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Nuk pajtohem aspak”.




Grafiku 18. *Mësuesja na jep sqarimet e nevojshme rreth detyrave të shtëpisë.*

Në pyetjen e tetëmbëdhjetë të hulumtimit qëllimi ishte të dihet se nxënësit si deklarohen se mësuesja e tyre u jep sqarimet e nevojshme rreth detyrave të shtëpisë dhe për këtë u përgjigjen me 32% e pjesëmarrësve “Pajtohem”, pastaj 30% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Neutral”, ndërsa 24% e pjesëmarrësve me “Pajtohem plotësisht” ndaj kësaj pyetje, 14% e pjesëmarrësve përgjigjen me “Nuk pajtohem” dhe 0% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Nuk pajtohem aspak”.




Grafiku 19. *Unë me dëshirë i kryej detyrat e shtëpisë..*

Në pyetjen e nëntëmbëdhjetë të hulumtimit qëllimi ishte të dihet se nxënësit si tregojnë që ata me dëshirë i kryejnë detyrat e shtëpise, dhe për këtë ata me 32% u përgjigjen me “Neutral”, pastaj 30% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem”, 30% e pjesëmarrësve qëndrojnë “Pajtohem plotësisht” ndaj kësaj pyetje, 0% e pjesëmarrësve përgjigjen me “Nuk pajtohem” dhe 0% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Nuk pajtohem aspak” .




Grafiku 20. *Prindërit më ndihmojnë çdoherë rreth detyrave të shtëpisë.*

Në pyetjen e njëzet të hulumtimit qëllimi ishte të dihet se nxënësit si tregojnë që prindërit e tyre u ndihmojnë çdoherë rreth detyrave të shtëpisë dhe për këtë në numër më të madh përkatësisht 46% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem”, pastaj 28% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem plotësisht”, ndërsa 26% e pjesëmarrësve qëndrojnë “Neutral” ndaj kësaj pyetje, 0% e pjesëmarrësve përgjigjen me “Nuk pajtohem” dhe 0% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Nuk pajtohem aspak”.



Grafiku 21. *Unë jam i pavarur në kryerjen e detyrave të shtëpisë.*


Në pyetjen e njëzet e një të hulumtimit qëllimi ishte të dihet se nxënësit si tregojnë që janë të pavarur në kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe për këtë në numër më të madh përkatësisht 48% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Neutral”, pastaj 26% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem”, ndërsa 16% e pjesëmarrësve qëndrojnë me “Pajtohem plotësisht” ndaj kësaj pyetje, 10% e pjesëmarrësve përgjigjën me “Nuk pajtohem” dhe 0% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Nuk pajtohem aspak”.



Grafiku 22. *Gjithmonë prindërit mi kontrollojnë detyrat e shtëpisë.*


Në pyetjen e njëzet e dytë të hulumtimit qëllimi ishte të dihet se nxënësit si tregojnë që prindërit gjithmonë u kontrollojnë detyrat e shtëpisë dhe për këtë në numër më të madh përkatësisht 50% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem”, pastaj 32% e pjesëmarrësve u përgjigjen me “Pajtohem plotësisht”, ndërsa 18% e pjesëmarrësve qëndrojnë me “Neutral” ndaj kësaj pyetje, 0% e pjesëmarrësve përgjigjen me “Nuk pajtohem” dhe 0% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Nuk pajtohem aspak”.






Grafiku 23. *Detyrat e shtëpisë ndikojnë në përforcimin e njohurive.*

Në pyetjen e njëzet e tretë të hulumtimit qëllimi ishte të dihet se sa ndikojnë detyrat e shtëpisë në përforcimin e njohurive dhe për këtë në numër më të madh përkatësisht 62% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem plotësisht”, pastaj 28% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem”, ndërsa 10% e pjesëmarrësve qëndrojnë me “Neutral” ndaj kësaj pyetje, 0% e pjesëmarrësve përgjigjën me “Nuk pajtohem” dhe 0% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Nuk pajtohem aspak”. Nga përgjigjet e pjesëmarrësve kuptojmë se detyrat e shtëpisë ndikojnë në përforcimin e njohurive.




Grafiku 24. *Detyrat e shtëpisë janë të domosdoshme për të arritur rezultatet e dëshiruara.*

Në pyetjen e njëzet e katërt të hulumtimit qëllimi ishte të dihet se a janë detyrat e shtëpisë të domosdoshme për të arritur rezultatet e dëshiruara dhe për këtë në numër më të madh përkatësisht 76% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem plotësisht”, pastaj 16% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem”, ndërsa 8% e pjesëmarrësve qëndrojnë me “Neutral” ndaj kësaj pyetje, 0% e pjesëmarrësve përgjigjën me “Nuk pajtohem” dhe 0% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Nuk pajtohem aspak”. Nga përgjigjet e pjesëmarrësve arrijmë në përfundim se detyrat e shtëpisë janë të domosdoshme për të arritur rezultatet e dëshiruara.




Grafiku 25. Përfshirja e prindërve në procesin e kryerjes së detyrave të shtëpisë, ndikon në përmirësimin e njohurive të asaj lënde mësimore.

Në pyetjen e njëzet e pestë të hulumtimit qëllimi ishte të dihet se si ndikon përfshirja e prindërve në procesin e kryerjes së detyrave të shtëpisë në përmirësimin e njohurive të saj lënde dhe për këtë në numër më të madh përkatësisht 80% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem plotësisht”, pastaj 14% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem”, ndërsa 6% e pjesëmarrësve qëndrojnë me “Neutral” ndaj kësaj pyetje, 0% e pjesëmarrësve përgjigjen me “Nuk pajtohem” dhe 0% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Nuk pajtohem aspak”. Nga përgjigjet e pjesëmarrësve kuptojmë se përfshirja e prindërve në procesin e kryerjes së detyrave të shtëpisë, ndikon në përmirësimin e njohurive të asaj lënde mësimore.



Grafiku 26. Tek unë gjithmonë detyrat e shtëpisë nxisin të menduarit.

Në pyetjen e njëzet e gjashtë të hulumtimit qëllimi ishte të dihet se si tek nxënësi gjithmonë detyrat shtëpisë nxisin të menduarit dhe për këtë në numër më të madh përkatësisht 62% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem”, pastaj 26% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem plotësisht”, ndërsa 8% e pjesëmarrësve qëndrojnë me “Neutral” ndaj kësaj pyetje, 4% e pjesëmarrësve përgjigjen me “Nuk pajtohem” dhe 0% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Nuk pajtohem aspak”.



Grafiku 27. *Gjatë kontrollimit të detyrave të shtëpisë nga mësuesja, unë kam gabime.*

Në pyetjen e njëzet e shtatë të hulumtimit qëllimi ishte të dihet se gjatë kontrollimit të detyrave të shtëpis nga mësuesja nxënësi ka gabime dhe për këtë në numër më të madh përkatësisht 60% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem”, pastaj 24% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Pajtohem plotësisht”, ndërsa 12% e pjesëmarrësve qëndrojnë me “Neutral” ndaj kësaj pyetje, 4% e pjesëmarrësve përgjigjen me “Nuk pajtohem” dhe 0% e pjesëmarrësve u përgjigjën me “Nuk pajtohem aspak”.

## 4.2. Të dhënat cilësore

### *Rezultatet e paraqitura nga perceptimet e mësimitdhënësve*

Të dhënat cilësore rrjedhin nga organizimi i intervistës me mësimitdhënësit e pesë shkollave urbane dhe rurale në komunën e Vushtrisë dhe Prishtinës, mësimitdhënësit janë nga shkalla e dytë e kurrikulës, pra klasave të treta, katërta dhe pesta. Intervistat janë realizuar individualisht dhe gjithsej janë tetë. Intervistat janë realizuar sipas renditjes së pyetjeve, gjatë intervistës janë mbajtur shënimet. Të gjitha intervistat janë realizuar për një periudhë kohore prej pesë ditësh. Duke konstatuar dhe analizuar perceptimet e mësimitdhënësve në lidhje me rëndësinë e detyrave të shtëpisë, kuptojmë se mësimitdhënësit në përgjithësi shprehin si të domosdoshëm procesin e detyrave të shtëpisë dhe përfshirjen e prindërve rreth detyrave të shtëpisë, që kur ka një bashkëpunim të mirë në mes të prindërve dhe mësimitdhënësve vërehet përmirësimi i nivelit të mësimitdhënësve.

### **I. Rëndësia e dhënies së detyrave të shtëpisë**

Mësimitdhënësit shprehin rëndësinë e pa diskutueshme të dhënies së detyrave të shtëpisë, ku e shohin si të nevojshme meqenëse kontribuojnë në përmirësimin dhe përfundimin e njohurive të fituara, dhe që mbajnë të angazhuar nxënësit në mësim.

**“Ndonjëherë mendoj se nëse nuk angazhohen me detyra të shtëpisë, nuk e shohin të nevojshme të mësojnë në shtëpi, me arsyen se nuk kanë detyra dhe mund t’i japin vetes liri për aktivitete tjera”.**

Se a japin detyra të shtëpisë për çdo orë çdo orë mësimore, kryesisht u shprehën se thuajse në çdo orë mësimore japin detyra të shtëpisë, sqaruan nevojën për të dhënë detyra të shtëpisë, ku nëse ka ndonjë ditë që nuk ju japin detyra me shkrim atëherë gjejnë ndonjë formë tjetër të angazhimit siç janë shikimi dhe mandej komentimi/shpjegimi i ndonjë videoje që ka të bëjë me lëndën/njësinë përkatëse.

**“Varësisht prej njësisë mësimore i jap edhe detyrat e shtëpisë. Çdo ditë I angazhoj me detyra por ndonjë ditë me detyra më të lehta e ndonjë ditë me detyra që kërkojnë më shumë kohë dhe përkushtim.”**

## II. Përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë

Mësimdhënësit kryesisht shprehen se prindërit duhet të jenë pjesë e rëndësishme në procesin e detyrave të shtëpisë dhe kështu duke i analizuar perceptimet e tyre vërejmë se mësimdhënësit paraqesin mendimet se prindërit duhet të përfshihen në jetën shkollore të fëmijës së tyre dhe në këtë mënyrë mësimdhënësit do të bashkëpunojnë me prindërit e fëmijëve, sepse bashkëpunimi prindër-mësimdhënës është ndër mënyrat më të mira për të ndihmuar fëmijët në kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe në përmirësimin/përforcimin e njohurive të tyre në procesin e mësimnxënies.

**“Mendoj që sikurse që është i domosdoshëm bashkëpunimi mes trekëndëshit pedagogjik, po ashtu e shoh si shumë të nevojshme edhe përfshirjen e prindërve rreth detyrave të shtëpisë. Nxënësit shumë herë kur nuk e kane vëmendjen tone, nuk përkushtohen në zgjidhjen e detyrave, pra, kopjojnë apo përshkruajnë dhe nuk përmbushin kërkesat dhe rezultatet e nevojshme.**

**Nëse nuk përfshihen prindërit ndodh që edhe nuk i bëjnë detyrat e shtëpisë.”**

Në çështjen për përfshirjen e prindërve në detyrat e shtëpisë për ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies, të gjithë mësimdhënësit deklarojnë se përfshirja e prindërve ka ndikim të madh në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies.

Përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë është i domosdoshëm dhe ka ndikim të jashtëzakonisht të madh në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies

Në çështje se cilat janë format më të shpeshta të ndihmës së ofruar nga prindërit për detyrat e shtëpisë, jo të gjithë kanë fatin të përfitojnë ndihmën adekuate nga prindërit e tyre sepse është niveli i shkollimit që i penalizon dhe shpeshherë kanë vështirësi për t'i ndihmuar fëmijët e tyre. Shumë prindër mundohen të ju japin sqarime shtesë që ndonjëherë thonë që hasin në kundërshtim me ta, me arsyen se mësuesja ka thënë ndryshe. Disa prindër vëzhgojnë gjithë procesin e zgjidhjes së detyrave dhe në fund kërkojnë nga fëmija i tyre që të sqaroj se çfarë ka bërë.

**“Varet nga profesioni i prindërve, niveli akademik i tyre. Ka prindër që thonë se unë vetëm mundem me i thënë me i bë detyrat se nuk jam në gjendje për ta ndihmuar më shumë, meqë nuk di.”**

Se a ka interesim nga ana e prindërve për të parë se a kanë detyra të shtëpisë dhe në këtë aspekt çfarë është bashkëpunimi i mësimdhënësve me prindërit, mësimdhënësit deklarojnë se shumë prindër shprehin interesim për detyrat por ka edhe shumë prindër që nuk shprehin këtë interesim, duke gjetur arsye se nuk kam kohë të merrem me detyrat e fëmijës tim. Kam shumë angazhime edhe për çka po vjen në shkollë.

Gjithë ata prindër që fëmijët e tyre në vazhdimësi vijnë pa detyra ose që nuk i bëjnë mirë, mundohen të bashkëpunojnë duke i thirrur në takime, ku ka raste që shprehin gatishmëri për bashkëpunim që ndikon në përmirësimin e rezultateve/suksesit, por që ka edhe raste që vazhdojnë me mos interesim dhe nuk janë bashkëpunues.

### **III. Përfshirja e nxënësve në detyrat e shtëpisë**

Mësimdhënësit konstatojnë rëndësinë e përfshirjes së nxënësve në detyrat e shtëpisë ku rol të rëndësishëm luan motivi dhe interesimi për kryerjen e detyrave.

Në çështjen që lidhet me kryerjen e detyrave nga të gjithë nxënësit, apo janë gjithmonë të njëjtit nxënës që i kryejnë detyrat shprehen se ka raste të ndryshme por kryesisht janë të njëjtit që i kryejnë detyrat e dhëna.

**“Si instrument të vlerësimit kam detyrat e shtëpisë dhe jo gjithmonë nxënësit kryejnë detyrat e shtëpisë. Normalisht se ata nxënës që i kryejnë detyrat janë shumë të përkushtuar dhe këtu nuk përjashtohet as interesimi i prindërve që fëmijët e tyre të vijnë me detyra të kryera ne shkollë. Këta nxënës tregojnë edhe rezultate me të mira në mësimë.”**



Nxënësit që nuk i kryejnë detyrat sikur nuk shqetësohen që marrin vlerësim të dobët dhe që vijnë vazhdimisht pa detyra. Sikur të kishin pas pak më shumë mbikëqyrje prej prindërve, mësimdhënësit mendojnë që këta nxënës që do të ndryshonin, do të përmirësoheshin në mësim.

Po ashtu rëndësi të veçantë paraqet edhe ndikimi i kryerjes së detyrave, që të tregojnë rezultate më të mira në procesin e mësimnxënies.

**“Patjetër që po, detyrat e shtëpisë kanë ndikim të madh në përmirësimin e nxënësve në mësim, për mësimnxënie sa më cilësore. Këta nxënës janë të përkushtuar, aktiv dhe me rezultate të larta në mësim. Këta nxënës janë shembull për të tjerët që të motivohen për kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe rëndësinë e të mësuarit.”**

Se sa janë nxënësit të vetëdijshëm për ndikimin e detyrave të shtëpisë në përforcimin e njohurive se se a i shohin sit ë domosdoshme për të arritur rezultate të dëshiruara, mësimdhënësit shprehin që nxënësit që kanë sukses të shkëlqyeshëm e kanë parasysh se çfarë ka ndikuar në suksesin e tyre. Janë të vetëdijshëm që ora mësimore nuk është e mjaftueshme nëse nuk angazhohen edhe në shtëpi. Nxënësit detyrat e shtëpisë i shohin si të domosdoshme për të përforcuar njohuritë e tyre.

## V. INTERPRETIMI DHE DISKUTIMI I REZULTATEVE

Në këtë kapitull paraqiten diskutimet e rezultateve të nxjerra nga perceptimet e prindërve, nxënësve dhe mësimitdhënësve për përfshirjen e prindërve në realizimin e detyrave të shtëpisë të nxënësit e shkollës fillore në shkallën e dytë të kurrikulës.

Nga ky hulumtim i realizuar në gjashtë shkolla të komunës së Prishtinës dhe Vushtrrisë, prej të cilave dy në zonë rurale dhe katër në atë urbane, përfundimisht mund të shohim se përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë ndihmon në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimitdhënies dhe mësimitnxënies. Kjo argumentohet duke u bazuar në hipotezën kryesore dhe hipotezën ndihmëse të hulumtimit si dhe në përgjigjet që kanë dhënë nxënësit, mësimitdhënësit dhe prindërit pjesëmarrës në studim, në pyetësorët e paraqitur me komentim, bazuar në grafiket e studimit dhe në përgjigjet e pjesëmarrësve të paraqitura përmes të dhënave cilësore.

Hipoteza kryesore e hulumtimit është se: ‘Përfshirja e prindërve në detyra të shtëpisë është faktor i rëndësishëm në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimitnxënies’, të cilën nga rezultatet e dala nga pyetësorët dhe intervistat, del që kjo hipotezë është vërtetuar.

Pikërisht, përgjigjet e pyetjes së trembëdhjetë dhe katërbëdhjetë të pyetësorëve me prindër, ku pyetja e trembëdhjetë ishte: Bashkëpunimi mësues-prind rreth detyrave të shtëpisë ndikon në arritjen e rezultateve të të nxënësve. 84% e prindërve janë përgjigjur se ‘Pajtohen plotësisht’, ndërsa te pyetja e katërbëdhjetë: Përfshirja e prindërve në detyrat të shtëpisë ndikon në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimitnxënies. 86 % e prindërve janë përgjigjur ‘Pajtohem plotësisht’.

Kjo vërtetohet edhe përmes pyetësorëve që është bërë me nxënës pjesëmarrës në studim ku në pyetjen e tetë: Detyrat e shtëpisë ndikojnë në përfshirjen e njohurive. 62% e nxënësve janë përgjigjur ‘Pajtohem plotësisht’, po ashtu te pyetja e nëntë: Detyrat e shtëpisë janë të domosdoshme për të arritur rezultatet e dëshiruara. 76% e nxënësve pjesëmarrës janë përgjigjur ‘Pajtohem plotësisht’, ndërsa në pyetjen e dhjetë: Përfshirja e prindërve në procesin e kryerjes së detyrave të shtëpisë, ndikon në përmirësimin e njohurive të asaj lënde mësimore. 80% e nxënësve janë përgjigjur ‘Pajtohem plotësisht’. Kjo vërtetohet edhe përmes intervistës që është bërë me mësimitdhënës të shkollave pjesëmarrës në studim, ku në pyetjen: A ndikon përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë për ngritjen e cilësisë në procesin e mësimitnxënies?, konstatuan që përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë është i domosdoshëm dhe ka ndikim të jashtëzakonisht të madh në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimitnxënies e po ashtu kjo vërtetohet edhe përmes pyetjes:

A është e nevojshme përfshirja e prindërve rreth detyrave të shtëpisë? Mësimdhënësit shprehen se prindërit duhet të jenë pjesë e rëndësishme në procesin e detyrave të shtëpisë dhe kështu duke i analizuar perceptimet e tyre vërejmë se mësimdhënësit paraqesin mendimet se prindërit duhet të përfshihen në jetën shkollë të fëmijës së tyre dhe në këtë mënyrë mësimdhënësit do të bashkëpunojnë me prindërit e fëmijëve, sepse bashkëpunimi prindër-mësimdhënës është ndër mënyrat më të mira për të ndihmuar fëmijët në kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe në përmirësimin/përforsimin e njohurive të tyre në procesin e mësimnxënies.

### **5.1. Diskutimi i rezultateve të perceptimeve të prindërve, nxënësve dhe mësimdhënësve për përfshirjen/ndikimin e prindërve në realizimin e detyrave të shtëpisë**

#### **Pyetja kërkimore kryesore:**

Sa ndikon përfshirja e prindërve në procesin e realizimit të detyrave të shtëpisë në suksesin e nxënësve të shkollës fillore të shkallës së dytë të kurrikulës?

Për këto pyetje është përdorur *metoda e përzier* si metodë e mbledhjes së të dhënave, e cila është kombinimi i metodës sasiore dhe cilësore.

Fillimisht përmes mbledhjes së të dhënave sasiore kemi marr perceptimet e prindërve dhe nxënësve për përfshirjen e prindërve në detyrat e shtëpisë, ndërsa përmes mbledhjes së të dhënave cilësore kemi marr perceptimet e mësimdhënësve dhe kemi arritur në përfundim se sipas mësimdhënësve përfshirja e prindërve procesin e realizimit të detyrave të shtëpisë, është faktor i rëndësishëm për ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies e që drejtpërdrejtë ndikon edhe në përmirësimin e rezultateve në mësim, në përforsimin e njohurive dhe arritjeve të rezultateve të dëshiruara në mësim. Është e pa diskutueshme rëndësia e dhënies së detyrave dhe përfshirjes së prindërve rreth detyrave të shtëpisë, meqë ndikon në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies. Nxënësit krijojnë shprehje të punës, kur e kanë parasysh që prindërit janë të përfshirë rreth detyrave të shtëpisë,

Nga rezultatet e nxjerra shohim se niveli i përfshirjes së prindërve në detyrat e shtëpisë është në nivel të duhur, këtë më së miri e shohim nga perceptimet e prindërve, të cilët shprehen se përfshirja e prindërve ndikon në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies, ku 86% ( shih grafikun 14) e prindërve pajtohen plotësisht, e njëjta gjë vlen edhe për fëmijët e tyre ku 76% pajtohen plotësisht që detyrat e shtëpisë janë të domosdoshme për të arritur rezultatet e dëshiruara.

## 5.2. Mënyrat më të mira të ofrimit të ndihmës nga ana e prindërve në detyrat e shtëpisë

### Pyetjet kërkimore ndihmëse:

*Çfarë roli kanë prindërit në procesin e realizimit të detyrave të shtëpisë të nxënësit e shkollës fillore?*

Disa nga prindërit shprehen se kanë rol të rëndësishëm në realizimin e detyrave dhe në përfshirjen e tyre në jetën shkollore të fëmijës së tyre dhe që mundohen në mënyra të ndryshme për t'i ofruar ndihmë ku së paku edhe fillojnë me interesimin se a kanë detyra të shtëpisë, e që nxënësit në pyetjen: Çdo ditë prindërit më pyesin për detyrat e shtëpisë, 52% shprehen se "Pajtohem" (shih grafikun 17) , ndërsa në pyetjen e njëjtë shtruar prindërve shprehen me të njëjtën përgjigje, pra 52% shprehen "Pajtohem" (grafiku 1)

Se çdo herë prindërit i ndihmojnë në detyra të shtëpisë nxënësit me përqindje prej 46% shprehen se "Pajtohen" ( grafiku 20) që lë për të dëshiruarën këtë aspekt.

Kësaj pyetje më së miri i përgjigjet pyetja se cila është forma më e zakonshme e ndihmës që i ofroni fëmijës në detyrat e shtëpisë prindërit shprehen kështu: 44 % "Jap sqarime", 42% vëzhgoj procesin e kryerjes së detyrave dhe 14% i tregoj zgjidhjet dhe përgjigjet (grafiku 11), ku e njëjta gjë vlen edhe për mësuesin se për të parë perceptimet se sa janë të ngjashme me të prindërve, mësuesin shprehen se varet nga profesioni i prindërve, niveli akademik i tyre. Ka prindër vetëm mundohen t'i detyrojnë/kërkojnë që t'i bëjnë detyrat sepse nuk janë në gjendje për t'i ndihmuar më shumë, meqë nuk dinë, nuk kanë njohuri të mjaftueshme për t'i ndihmuar.

Shumë prindër mundohen të ju japin sqarime shtesë që ndonjëherë thonë që hasin në kundërshtim me ta, me arsyen se mësuesja ka thënë ndryshe.

Disa prindër vëzhgojnë gjithë procesin e zgjidhjes së detyrave dhe në fund kërkojnë nga fëmija i tyre që të sqaroj se çfarë ka bërë.

### **5.3. Diskutimi i rezultateve për ndikimin e bashkëpunimit prind-mësimdhënës për detyrat e shtëpisë në arritjet e nxënësve**

**Pyetjet kërkimore ndihmëse:** *Si ndikon bashkëpunimi prind-mësues për detyrat e shtëpisë në arritjet e nxënësve?*

Nga rezultatet e nxjerra shohim se niveli i bashkëpunimit të mësimdhënësve me prindërit në shkollat tona është në nivel të duhur, këtë më së miri e shohim nga perceptimet e prindërve, të cilët me përqindje prej 84% (shih grafikun 13) shprehen se bashkëpunimi mësues-prind rreth detyrave të shtëpisë ndikon në arritjen e rezultateve të të nxënësve, ku e njëjta gjë vlen edhe për mësimdhënësit të cilët të pyetur se a ka interesim nga ana e prindërve për të parë se a kanë detyra të shtëpisë dhe në këtë aspekt çfarë është bashkëpunimi juaj me ta? Shprehen se shumë prindër shprehin interesim për detyrat, por ka edhe shumë prindër që nuk shprehin këtë interesim, duke gjetur arsye se nuk kam kohë të merrem me detyrat e fëmijës tim. Kam shumë angazhime edhe për çka po vjen në shkollë.

Mësimdhënësit shprehen se me prindërit që nuk janë bashkëpunues dhe nuk shfaqin interesim për të parë se a kanë detyra dhe si është gjendja e tyre në vlerësim, mundohen që t'i thërrasin në takime, ku normalisht ka raste që gjejnë bashkëpunim dhe përmirësohet ai nxënës, por që ka edhe raste që nuk janë bashkëpunues dhe gjendja e nxënësit vazhdon të mbetet e njëjtë. Për të vërtetuar këtë pyetje edhe nxënësit e prindërit në përqindje të madhe u shprehen se pajtohen, ndërsa përqindje më të ulët që pajtohen plotësisht.

Për të kuptuar se sa ndajnë kohë për t'i ndihmuar fëmijët e tyre dhe në këtë mënyrë për të kuptuar përkushtimin e tyre ndaj fëmijëve të tyre prindërit shprehen 30-40 min 40%, 10-20 min 32%, 1-2 orë 24% dhe nuk i ndihmoj 4% (grafiku 6).

Për të kuptuar se a kontrollohen gjithmonë detyrat e shtëpisë nga ana e prindërve, nxënësit shprehen 50% pajtohen (grafiku 22).

Bashkëpunimi prindër-mësimdhënës është ndër mënyrat më të mira për të ndihmuar fëmijët në arritjet dhe përparimin e tyre në përgjithësi dhe se komunikimi me prindër është mënyra më e efektshme për t'i ndihmuar fëmijës në mësim.

#### **5.4. Diskutimi i rezultateve për vështirësitë që hasin prindërit dhe mësime të shtëpisë realizimit dhe kontrollimit të detyrave të shtëpisë**

Rezultatet treguan se si një ndër vështirësitë që i shohin nxënësit për t'i bërë detyrat e shtëpisë është se janë të angazhuar çdo ditë e në secilën lëndë, sipas orarit mësimor me detyra të shtëpisë, ku nxënësit shprehen 56% pajtohem plotësisht (grafiku 16), ku perceptimet e prindërve se fëmija im është i ngarkuar me detyra të shtëpisë janë 32% (grafiku 3) nuk pajtohem aspak që del se nuk ndajnë të njëjtin mendim me fëmijët e tyre.

Për të parë perceptimet e prindërve se a mendojnë se është e nevojshme dhënia e detyrave të shtëpisë dhe për të kuptuar se a paraqitet si vështirësi dhënia e detyrave, mësime të shtëpisë konsiderojnë se është shumë e nevojshme dhënia e detyrave të shtëpisë sepse kontribuojnë në përmirësimin dhe përforsimin e njohurive të fituara dhe se a japin detyra për çdo orë mësimore ose sa herë në javë dhe nëse nuk japin detyra, në çfarë mënyre tjetër i angazhojnë nxënësit mësime të shtëpisë shprehen se varësisht prej njësive mësimore japin detyra, e që kur nuk ju japin detyra, i angazhojnë për të lexuar apo shikuar ndonjë videoinqizim që do ta shpjegojnë në shkollë. Të pyetur se gjatë procesit të kryerjes së detyrave, ju si prindër në cilat faza keni vështërsi? rezultatet e hulumtimit tregojnë perceptimet e prindërve ku 58% në fazën e bindjes së fëmijës në rrugën e zgjidhjes, 26% në fazën e kryerjes së detyrave të shtëpisë dhe 16 % në fazën përgatitore (shih grafikun 10).

#### **5.5. Diskutimi i rezultateve për gjetjen e mënyrave më të mira nga prindërit dhe mësime të shtëpisë për realizimin e detyrave të shtëpisë dhe nivelin e bashkëpunimit mes tyre**

Rezultatet e hulumtimit tregojnë se prindërit dhe mësime të shtëpisë kanë gjetur mënyrat më të mira për realizimin e detyrave të shtëpisë dhe nivelin e bashkëpunimit mes tyre.

Për të realizuar detyrat e shtëpisë në mënyrën më të mirë është e rëndësishme që fëmijët me dëshirë t'i kryejnë detyrat e shtëpisë, të kuptojnë rëndësinë dhe ndikimin e detyrave në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies.

Përceptimet e nxënësve në pyetjen se unë me dëshirë i kryej detyrat e shtëpisë 32 % përgjigjen neutral (grafiku 19), e pothuajse të njëjtën përgjigje e marrim edhe nga prindërit të cilët thonë se 34 % pajtohem (grafiku 4) që fëmija im me dëshirë i kryen detyrat e shtëpisë.

Duke ditur që çelësi i suksesit është tek motivi i nxënësve për mësim dhe realizimi i detyrave dhe se ndikojnë në rezultate më të mira në procesin e mësimnxënies mësimdhënësit u shprehën se nxënësit që i bëjnë detyrat kanë përmirësime janë të shkëlqyeshëm në mësim. Këta nxënës janë të përkushtuar, aktiv dhe me rezultate të larta në mësim. Këta nxënës janë shembull për të tjerët që të motivohen për kryerjen e detyrave të shtëpisë dhe rëndësinë e të mësuarit.

Nxënësit që kanë sukses të shkëlqyeshëm e kanë parasysh se çfarë ka ndikuar në suksesin e tyre. Janë të vetëdijshëm që ora mësimore nuk është e mjaftueshme nëse nuk angazhohen edhe në shtëpi. Nxënësit detyrat e shtëpisë i shohin si të domosdoshme për të përforcuar njohuritë e tyre. Bashkëpunimi për mënyrën e ofrimit të ndihmës, për kohën që duhet ofruar fëmijëve për realizimin e detyrave është një faktor i rëndësishëm për arritjet sa më të larta në mësim.

## VI. PËRFUNDIMET DHE REKOMANDIMET

Duke u bazuar në të dhënat kuantitative dhe kualitative të analizuar të hulumtimit janë nxjerrë përfundimet. Të gjeturat e hulumtimit janë analizuar përmes analizave statistikore dhe analizës cilësore. Arritja e rezultateve të dëshirueshme në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies është arsyeja kryesore për të arsimuar brezat e rinj, por që në ditët e sotme është mjaft sfiduese duke pasur parasysh ndryshimet dhe zhvillimet e kohës. Prandaj, përfshirja e prindërve, veçanërisht në realizimin e detyrave të shtëpisë të nxënësit e shkollës fillore në shkallën e dytë të kurrikulës është domosdoshmëri që ka ndikim shumë të madh në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies, është një ndër faktorët më kontribues në transformimin pozitiv që do të ndodhte për arritjen e suksesshme të rezultateve të përgjithshme.

Nga qëndrimet e analizuar arrijmë në përfundim se sipas prindërve, nxënësve dhe mësimdhënësve, përfshirja e prindërve në procesin e realizimit të detyrave të shtëpisë, është faktor i rëndësishëm për ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies e që drejtpërdrejtë ndikon edhe në përmirësimi e rezultateve në mësim, në përforcimin e njohurive dhe arritjeve të rezultateve të dëshiruara në mësim.

Nga perceptimet e analizuar arrijmë në përfundim se prindërit dhe mësimdhënësit kanë gjetur mënyrat për t'i ndihmuar fëmijët në realizimin e detyrave të shtëpisë, kjo është arritur duke biseduar me prindërit për rëndësinë e detyrave dhe duke bashkëndarë me ta mënyrat më të mira të ofrimit të ndihmës, si: të pyesin fëmijën e tyre se a ka detyra të shtëpisë, ta motivojë për zgjidhjen e detyrave, ta kontrolloj gjatë zgjidhjes së detyrave, të jep sqarime nëse është e nevojshme, ta udhëzoj, të vëzhgoj procesin e kryerjes së detyrave por asnjëherë t'i jep zgjidhjet e detyrave.

Një element mjaft i rëndësishëm i nxjerr nga këto të dhëna thekson si përfundim se bashkëpunimi mësimdhënës-prind është në nivel të duhur.

Bashkëpunimi prindër-mësimdhënës është ndër mënyrat më të mira për të ndihmuar fëmijët në arritjet dhe përparimin e tyre në përgjithësi dhe se komunikimi me prindër është mënyra më e efektshme për t'i ndihmuar fëmijës në mësim.

Përmes komunikimit dhe bashkëpunimit të hapur, prindërit dhe mësimdhënësit krijojnë mundësi të rëndësishme për nxënësit për të zhvilluar aftësitë shoqërore, emocionale dhe akademike që i shoqërojnë gjatë gjithë jetës.

Nga analiza e të dhënave sasiore dhe cilësore të prindërve dhe mësimdhënësve për vështirësitë që hasin prindërit dhe mësimdhënësit gjatë realizimit dhe kontrollimit të detyrave të shtëpisë arrijmë



në përfundim se shumica e prindërve pra 58% kanë vështirësi në fazën e bindjes së fëmijës në rrugën e zgjidhjes, 26% në fazën e kryerjes së detyrave të shtëpisë dhe 16 % në fazën përgatitore. Përfshirja e prindërve është mjaft e rëndësishme në procesin e të mësuarit të fëmijëve, në mendimin e tyre për shkollën dhe në aspiratat e tyre. Fëmijët janë nxënës më të suksesshëm përgjatë gjithë shkollës nëse prindërit e tyre përfshihen në shkollë dhe inkurajojnë të mësuarit në shtëpi, pavarësisht vështirësive që paraqiten.

Qëndrimet e prindërve dhe mësimeve për gjetjen e mënyrave më të mira për realizimin e detyrave të shtëpisë dhe nivelin e bashkëpunimit mes tyre nga diskutimet e bëra edhe më lartë arrijmë në përfundim që për të realizuar detyrat e shtëpisë në mënyrën më të mirë është e rëndësishme që fëmijët me dëshirë t'i kryejnë detyrat e shtëpisë, të kuptojnë rëndësinë dhe ndikimin e detyrave në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies.

### **6.1. Rekomandimet**

Gjatë procesit të hulumtimit duke u bazuar në shqyrtimin e literaturës, të dhënave sasiore dhe të dhënave cilësore mund të konstatojmë se qëndrimet e prindërve, mësimeve dhe nxënësve lidhur me përfshirjen e prindërve në realizimin e detyrave të shtëpisë, ndikon në ngritjen e cilësisë, në përmirësimin e nxënësve në mësim dhe arritjen e rezultateve të dëshiruara. Nga krejt kjo rekomandimet që sugjerohen për institucionet kompetente si dhe gjithë aktorët e procesit edukativo-arsimor janë që:

- Që të merret parasysh rëndësia e përfshirjes së prindërve në realizimin e detyrave të shtëpisë me qëllim që të kemi ngritje të cilësisë në procesin e mësimnxënies.
- Të vazhdojnë me punën e mirë që bëjnë, por që ndonjëherë në qoftë se nuk funksionojnë këto metoda të marrin këshilla edhe nga njëri-tjetri po ashtu edhe nga ekspertë të fushës së edukimit.
- Që bashkëpunimi ndërmjet mësimeve dhe prindërve të vazhdojë tutje, por që secilën herë të jetë edhe më i lartë ky nivel në mënyrë që t'i ndihmojnë fëmijët të tregojnë rezultate të shkëlqyeshme në procesin e mësimnxënies.
- Prindërve iu rekomandohet të vazhdojnë me përfshirjen e tyre në ambientin shkollor, për t'iu dal në ndihmë fëmijëve të tyre në jetën shkollore.

- Mësimdhënësve iu rekomandohet të vazhdojnë dhe ta rrisin nivelin e bashkëpunimit me prindër.
- Që prindërit dhe mësimdhënësit të vazhdojnë të bashkëpunojnë mes tyre, në qoftëse do të ketë ndonjëherë ndonjë vështirësi, ajo të tejkalohet përmes komunikimit të ndërsjellë.
  - Vetëdijësimi i mëtutjeshëm i prindërve në rolin e tyre, për ndihmën që mund t'ia bëjnë fëmijëve të tyre në realizimin e detyrave të shtëpisë.
  - Vetëdijësimi i mëtutjeshëm i mësimdhënësve në rolin e tyre për ndihmën që mund t'ia bëjnë nxënësve të tyre për kryerjen e detyrave në nivelin e duhur.
- Përcjellja e fëmijës në mësim nga ana e prindërve, për të parë nivelin e arritjeve dhe zbatimin e mënyrave efektive në përmirësimin e tyre në mësim.
- Dhënia e sqarimeve të nevojshme nga ana e mësimdhënësve, dhënia e informacioneve të vazhdueshme për prindër dhe inkurajimi i prindërve për bashkëpunim.

## **6.2.Limitet**

Përkundër faktit që ky studim është realizuar me kujdes të konsiderueshëm, në mënyrë që të sigurojë saktësinë e rezultateve të paraqitura, duhet pranuar se i njëjti ka pasur edhe kufizimet apo limitet e veta. Duke e ditur se grumbullimi i të dhënave në gjendjen e pandemisë në të cilën ndodhemi që dy vite shkak i paraqitjes së virusi COVID/19 ishte mjaft sfiduese ku si limit i parë apo kufizim i studimit parqitet shpërndarja e pyetësorëve dhe intervistimi i mësimdhënësve, ku procesi mësimor zhvillohej në dy grupe e që po ashtu duhej pritur që të ktheheshin nga mësimi në skenarin C (online).

Për të njëjtën arsye edhe grumbullimi i të dhënave nga pyetësorët me prindër ku shkak i kalimit të shkollave në skenarin C (online) u pamundësua shpërndarja e pyetësorëve në mënyrë fizike, prandaj në disa shkolla grumbullimi të dhënave është bërë online.

Si limit të dytë apo kufizim i studimit konsiderohet gjithashtu edhe intervistimi i mësimdhënësve në mënyrë online, për shkaqe të cekura më lartë.

Megjithëse hulumtimi është kryer sipas rregullave të përcaktuara hulumtuese, ku të dhënat janë mbledhur duke i repektuar këto rregull, por që normalishtë vështërsitë për të përfshirë në tërësi problemin paraqet vështirësi ku si limit i tretë mund të themi se është mostra jo e madhe, pra për të pasur rezultate më përfaqësuese dhe më përgjithësuese do të duhej që hulumtimi të kishte një

shtrirje më të gjerë dhe poashtu të përfshihej një numër më i madh i pjesëmarrësve. Duke pasur parasysh se problemi i trajtuar në këtë hulumtim është mjaft i gjerë dhe duhet shikuar nga këndvështrime të ndryshme si limit i katërt i hulumtimit janë dhe mbledhja e të dhënave vetëm përmes pyetësorëve dhe intervistës, sepse për të studiuar një temë në nivelin më të lartë do të ishte e domosdoshme dhe kombinimi i më shumë metodave të tjera studimore për të dhënë detaje më të hollësishme.

Meqë studimi është bërë duke përfshirë dy komuna pra nga zona urbane dhe rurale, si limit i pestë paraqitet grumbullimi i të dhënave pa bërë ndarjen mes zones urbane dhe rurale, ku do të kishte shumë rëndësi ndarja e përceptimeve duke bërë dallimin mes zones urbane dhe rurale por nga që do të ishte studim shumë i gjërë, duhej të përfshiheshin në mënyrë të përgjithshme duke mos bërë dallime mes zonave.

### **6.3.Implikimet praktike**

Ky hulumtim na bënë të mundur që të njihemi nga afër me përceptimet e mësimdhënësve, prindërve dhe të nxënësve për ndikimin e përfshirjes së prindërve në realizimin e detyrave të shtëpisë, të shohim rëndësinë e madhe në kohën që po jetojmë, ndryshimet dhe reformat në arsim dhe të kuptuarit e drejtë të ndryshimeve që po ndodhin në procesin e mësimdhënies dhe mësimnxënies, zhvillimi i shkathtësive në realizimi e detyrave sipas kërkesave të nevojshme dhe nivelit të duhur. Me përfshirjen e prindërve në realizimin e detyrave, mësimdhënësit janë në gjendje të gjykojnë mbi përpjekjet e nxënësve për të nxënë, të motivojnë dhe të nxisin nxënësit për të nxënë, të gjykojnë, të reflektojnë dhe të përmirësojnë procesin e mësimnxënies, të masin arritjet e nxënësve, të raportojnë arritjet e të nxënësve si dhe t'u japin sugjerime nxënësve për përparimin e tyre. Duke u bazuar në këtë pritjet që në të ardhmen prindërit t'i kushtojnë një rëndësi të madhe përfshirjes së tyre në jetën shkollore të fëmijëve të tyre në mënyrë që edhe vetë atyre të mos ju shfaqen barriera për arritjen e rezultateve të të nxënësve të fëmijëve të tyre. Këto përceptime si dhe përvoja të mësimdhënësve dhe prindërve mund të jenë një bazë e mirë për përmirësimin e cilësisë në procesin e mësimdhënies.

## REFERENCAT BIBLIOGRAFIKE

- Cancio, E. J., West, R. P., & Young, K. R. (2004). Improving mathematics homework completion and accuracy of students with EBD through self-management and parent participation. *Journal of Emotional and Behavioral Disorders*, 12(1), 9–22.
- Cooper. H. (2006). *The Battle Over Homework: Common Ground for Administrators, Teachers, and Parents*. Corëin Press.
- Cooper. H. (2007). *The Battle Over Homework: Common Ground for Administrators, Teachers, and Parents*. Corëin Press.
- Cooper, H., & Valentine, J. C. (2001). Using Research to Answer Practical Questions About Homework. *Educational Psychologist*, 143-153.
- Cooper, H., Robinson, J., & Patall, E. (2006). Does Homework Improve Academic Achievement? A Synthesis of Research, 1987–2003. *Review of Educational Research*, 1-62.
- Coutts, P. (2004). Meanings of Homework and Implications for Practice. *Theory Into Practice*, 182-188.
- Cunha, Jennifer; Rosário, Pedro; Macedo, Lúcia; Nunes, Ana Rita; Fuentes, Sonia; Pinto, Ricardo; Suárez, Natalia. (2015). Parents' conceptions of their homework involvement in elementary school, *Psicothema*, Universidad de Oviedo Oviedo, España.
- Deslandes, R. (2001). A Vision of Home-School Partnership: Three complementary conceptual frameworks. Marrë nga: <http://www.its.kun.nl/web/publikaties/pdf/files/rapporten/aBridgetothefuture.pdf>, më 21 nëntor 2020
- Deslandes, R. (2009). Elementary School Teachers' Views of Homework and Parents–School Relations. In R. Deslandes, *International Perspectives on Student Outcomes and Homework* (pp. 144-156). London: Routledge.
- Eccles, J. S., & Harold, R. D. (1993). Parent-school involvement during the early adolescent years. *Teachers College Record*, 94, 568-587.
- Epstein, J. (2001). *Preparing Educators and Improving Schools. School, Family and Community Partnerships*. Westview Press.
- Epstein, L., Joyce & Voorhis, Van, L., Frances, (2001). More than Minutes: Teachers' Roles in Designing Homework, Center on school, Family, and Community Partnerships, Johns Hopkins University, *Educational Psychologist*, 36(3), 181-193.

- E Epstein, J. L., & Van Voorhis, F. L. (2001). More Than Minutes: Teachers' Roles in Designing Homework. *Educational Psychologist*, 185-193.
- Georgiou, S. N., & Tourva, A. (2007). Parental attributions and parental involvement. *Social Psychology of Education*.
- Haliti, Sh. (2007). Në kërkim të pedagogjisë Reformuese, Gjilan.
- Hoover-Dempsey, K.V., Bassler, O.C., & Burow, R. (1995). Parents' reported involvement in students' homework: Strategies and practices. *Elementary School Journal*, 95, 435-450.
- Hoover-Dempsey, K. V., & Sandler, H. M. (1995). Parental involvement in children's education: Why does it make a difference? *Teachers College Record*, 95, 310-331.
- Hoover-Dempsey, K. V. (1997). Why do parents become involved in their children's education?. Review of educational research. Marrë nga:  
<https://journals.sagepub.com/doi/abs/10.3102/00346543067001003>, më 20 nëntor 2020.
- Hoover-Dempsey, K. V. (2005). Why do parents become involved? Research findings and implications. *The elementary school journal* 105-130. Marrë nga:<https://prod-edxapp.edx-cdn.org/assets/courseware/v1/21416d4885f065d20a015ba8dd103b9a/asset-v1:HarvardX+GSE4x+3T2017+type@asset+block/WhydoParentsBecomeInvolved.pdf>, më 22 nëntor 2020.
- Kohn, A. (2007). Rethinking Homework. *PRINCIPAL-ARLINGTON*, 35-38.
- MASHT. (2016, October 25). Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë. Retrieved March 14,2018,from:www.masht.rks-gov.net:<https://masht.rks.gov.net/uploads/2017/03/korniza-kurrikulare-finale.pdf>.
- Montalvo, F & Torres, M. (2004). Self-regulated Learning: Current and Future Directions. *Elektronic Journal of Research in Educational Psychology*, 2 (1), 1-34.
- Murchan, D., Shiel, G., & Vula, E. (2011). *Vlerësimi Formativ*. Prishtinë, Kosovë: USAID & MASHT.
- Patton, M. Q. (2002). *Qualitative evaluation and research methods* (3rd ed.). Neëbury Park, CA: Sage.
- Pupovci, D. Tafarshiku, N. (2008). Pjesëmarrja e prindërve në jetën e shkollës në Kosovë, Prishtinë, KEC.
- Rooney, C. (2008): How am I using inquiry-based learning to improve my practice and to encourage higher order thinking among my students of mathematics? *Educational Journal of Living Theories*. ISSN 2009-1788. Volume 5(2): 99-127.

- Starkey, P., & Klein, A. (2000). Fostering parental support for children's mathematical development: An intervention with Head Start families. *Early Education and Development*, 11, 659–680.
- Sheldon, S., Epstein J,L(2000):Involvement counts, family and community partnerships and mathematics achievements, *Journal of educational research*.
- Valle, A., Regueiro, B., Núñez, J. C., Rodríguez, S., Piñeiro, I., & Rosário, P. (2016). Academic Goals, Student Homework Engagement, and Academic Achievement in Elementary School. *Frontiers in Psychology*, 1-10.
- Warton, P. M. (2001). The Forgotten Voices in Homework: Views of Students. *Educational Psychologist* , 155-165
- ZUNA Deva, A., & bashkautorët. (2009). Format e partneritetit shkollë-familje-komunitet. U *Partnertiteti shkollë-familje-komunitet* (str. 200-223). Prishtinë: Libri shkollor.

## SHTOJCA 1. Pyetësor për prindër

### PYETËSOR

*Të nderuar prindër!*

*Pyetësori që keni në dorë, ka të bëjë me një hulumtim që po bëhet si e pjesë e studimit lidhur me përfshirjen e prindërve në realizimin e detyrave të shtëpisë të nxënësve të shkollës fillore në shkollën e dytë të kurrikulës. Përgjigjet tuaja të sinqerta do të më ndihmonin që të nxjerr rezultate sa më të sakta dhe konkrete. Ky pyetësor është krejtësisht anonim dhe këto të dhëna do të përdoren vetëm për verifikimin e qëllimeve shkencore lidhur me këtë çështje.*

*Duke iu falënderuar për pjesëmarrje, në vazhdim kërkojmë nga ju të lexoni secilën pyetje me vëmendje dhe të jepni vlerësimin tuaj për secilën pyetje në veçanti. Ju lutem qarkoni njërin nga kutizat që mendoni se i përgjigjet më së miri mendimit tuaj.*

*Ju faleminderit për bashkëpunim!*

*Me respekt, Gresa Salihu!*

### INFORMACIONE TË PËRGJITHSHME

a. Shkolla ku vijon mësimet fëmija im: \_\_\_\_\_

b. Gjinia

Mashkull

Femër

c. Moshë

Më pak se 25

25-29

30-39

40-49

50-59

ç. Niveli më i lartë i edukimit tuaj:

Shkollë fillore

Shkollë e mesme

Fakultet

Master

Tjetër

Ju lutem zgjedhni opsionin duke e vendosur shenjën (√) te kutiza përkatëse që përshtatet me mendimin tuaj!

1	Unë çdo ditë pyes fëmijën tim për detyrat e shtëpisë. <input type="checkbox"/> Nuk pajtohem aspak <input type="checkbox"/> Nuk pajtohem <input type="checkbox"/> Neutral <input type="checkbox"/> Pajtohem <input type="checkbox"/> Pajtohem plotësisht
2	Fëmija im ka çdo ditë detyra të shtëpisë. <input type="checkbox"/> Nuk pajtohem aspak <input type="checkbox"/> Nuk pajtohem <input type="checkbox"/> Neutral <input type="checkbox"/> Pajtohem <input type="checkbox"/> Pajtohem plotësisht

3	<p>Fëmija im është i ngarkuar me detyra të shtëpisë.</p> <p><input type="checkbox"/> Nuk pajtohem aspak</p> <p><input type="checkbox"/> Nuk pajtohem</p> <p><input type="checkbox"/> Neutral</p> <p><input type="checkbox"/> Pajtohem</p> <p><input type="checkbox"/> Pajtohem plotësisht</p>
4	<p>Fëmija im me dëshirë i kryen detyrat e shtëpisë.</p> <p><input type="checkbox"/> Nuk pajtohem aspak</p> <p><input type="checkbox"/> Nuk pajtohem</p> <p><input type="checkbox"/> Neutral</p> <p><input type="checkbox"/> Pajtohem</p> <p><input type="checkbox"/> Pajtohem plotësisht</p>
5	<p>Fëmijës tim çdo ditë ia kontrolloj detyrat e shtëpisë.</p> <p><input type="checkbox"/> Nuk pajtohem aspak</p> <p><input type="checkbox"/> Nuk pajtohem</p> <p><input type="checkbox"/> Neutral</p> <p><input type="checkbox"/> Pajtohem</p> <p><input type="checkbox"/> Pajtohem plotësisht</p>
6	<p>Përafërsisht sa kohë brenda ditës i ndihmoni fëmijës rreth detyrave të shtëpisë?</p> <p><input type="checkbox"/> 10-20 min <input type="checkbox"/> 30- 40 min <input type="checkbox"/> 1-2 orë <input type="checkbox"/> 2-3 orë <input type="checkbox"/> Nuk i ndihmoj</p>
7	<p>Cili nga prindërit ndihmon më shumë fëmijën rreth detyrave të shtëpisë?</p> <p><input type="checkbox"/> Nëna <input type="checkbox"/> Babai</p>
8	<p>Fëmija im është i pavarur në kryerjen e detyrave të shtëpisë.</p> <p><input type="checkbox"/> Nuk pajtohem aspak</p> <p><input type="checkbox"/> Nuk pajtohem</p> <p><input type="checkbox"/> Neutral</p> <p><input type="checkbox"/> Pajtohem</p> <p><input type="checkbox"/> Pajtohem plotësisht</p>
9	<p>Gjatë kryerjes së detyrave të shtëpisë ju si prindër i referoheni:</p> <p><input type="checkbox"/> Tekstit mësimor <input type="checkbox"/> Porosive të mësuesit <input type="checkbox"/> Përvojës tuaj <input type="checkbox"/> Tjetër</p>
10	<p>Gjatë procesit të kryerjes së detyrave , ju si prindër në cilat faza keni vështirësi?</p> <p><input type="checkbox"/> Në fazën përgatitore <input type="checkbox"/> Në fazën e kryerjes së detyrave <input type="checkbox"/> Në fazën e bindjes së fëmijës me rrugën e zgjidhjes</p>
11	<p>Cila është forma më e zakonshme e ndihmës që i ofroni fëmijës në detyra të shtëpisë?</p> <p><input type="checkbox"/> I jap sqarime <input type="checkbox"/> I tregoj zgjidhjet dhe përgjigjet <input type="checkbox"/> Vëzhgoj procesin e kryerjes së detyrave</p>
12	<p>Përfshirjen tuaj në procesin e kryerjes së detyrave të shtëpisë në shtëpi e cilësoni si:</p> <p><input type="checkbox"/> Përkrahje</p> <p><input type="checkbox"/> Zgjidhje</p>



	<input type="checkbox"/> Mundësi për pavarësi <input type="checkbox"/> Pengesë për punë të pavarur
13	Bashkëpunimi mësues-prind rreth detyrave të shtëpisë ndikon në arritjen e rezultateve të të nxënit. <input type="checkbox"/> Nuk pajtohem aspak <input type="checkbox"/> Nuk pajtohem <input type="checkbox"/> Neutral <input type="checkbox"/> Pajtohem <input type="checkbox"/> Pajtohem plotësisht
14	Përfshirja e prindërve në detyra të shtëpisë ndikon në ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies . <input type="checkbox"/> Nuk pajtohem aspak <input type="checkbox"/> Nuk pajtohem <input type="checkbox"/> Neutral <input type="checkbox"/> Pajtohem <input type="checkbox"/> Pajtohem plotësisht
15	Detyrat e shtëpisë ndikojnë në zhvillimin e të menduarit kritik. <input type="checkbox"/> Nuk pajtohem aspak <input type="checkbox"/> Nuk pajtohem <input type="checkbox"/> Neutral <input type="checkbox"/> Pajtohem <input type="checkbox"/> Pajtohem plotësisht

## SHTOJCA 2. Pyetësor për nxënës

### PYETËSOR

*Të nderuar nxënës!*

*Pyetësi që keni në dorë, ka të bëjë me një hulumtim që po bëhet si pjesë e studimit lidhur me përfshirjen e prindërve në realizimin e detyrave të shtëpisë të nxënësve të shkollës fillore të shkollës në dytë të kurrikulës. Përgjigjet tuaja të sigjerta do të më ndihmonin që të nxjerr rezultate sa më të sakta dhe konkrete. Ky pyetësor është krejtësisht anonim dhe këto të dhëna do të përdoren vetëm për verifikimin e qëllimeve shkencore lidhur me këtë çështje.*

*Duke iu falënderuar për pjesëmarrje, në vazhdim kërkojmë nga ju të lexoni secilën pyetje me vëmendje dhe të jepni vlerësimin tuaj për secilën pyetje në veçanti. Ju lutem qarkoni njërin nga numrat që mendoni se i përgjigjet më së miri mendimit tuaj.*

*Ju faleminderit për bashkëpunim!*

*Me respekt, Gresa Salihu!*

**Shënim: 5– Pajtohem plotësisht; 4 – Pajtohem; 3 - Neutral; 2– Nuk pajtohem; 1 – Nuk pajtohem aspak**

*Për të dhënë përgjigjen/mendimin tuaj, ju lutemi (rrethoni) numrin përkatës*

1	Unë çdo ditë në secilën lëndë, sipas orarit mësimor kam detyra të shtëpisë.	5 4 3 2 1
2	Çdo ditë prindërit më pyesin për detyrat e shtëpisë.	5 4 3 2 1
3	Mësuesja na jep sqarimet e nevojshme rreth detyrave të shtëpisë.	5 4 3 2 1
4	Unë me dëshirë i kryej detyrat e shtëpisë.	5 4 3 2 1
5	Prindërit më ndihmojnë çdoherë rreth detyrave të shtëpisë.	5 4 3 2 1
6	Unë jam i pavarur në kryerjen e detyrave të shtëpisë.	5 4 3 2 1

7	Gjithmonë prindërit mi kontrollojnë detyrat e shtëpisë.	5 4 3 2 1
8	Detyrat e shtëpisë ndikojnë në përforcimin e njohurive.	5 4 3 2 1
9	Detyrat e shtëpisë janë të domosdoshme për të arritur rezultatet e dëshiruara.	5 4 3 2 1
10	Përfshirja e prindërve në procesin e kryerjes së detyrave të shtëpisë, ndikon në përmirësimin e njohurive të asaj lënde mësimore.	5 4 3 2 1
11	Tek unë gjithmonë detyrat e shtëpisë nxisin të menduarit.	5 4 3 2 1
12	Gjatë kontrollimit të detyrave të shtëpisë nga mësuesja, unë kam gabime.	5 4 3 2 1

## **SHTOJCA 3.Intervista për mësimdhënës**

### **Kategoria 1: Rëndësia e dhënies së detyrave të shtëpisë**

- I.1. A mendoni se është e nevojshme dhënia e detyrave të shtëpisë? Nëse po, shpjegoni përse.
- I.2. Detyrat e shtëpisë a i jepni për çdo orë mësimore? Nëse jo, sa herë në javë dhe nëse nuk jepni fare detyra, në çfarë mënyre tjetër i angazhoni nxënësit?

### **Kategoria 2: Përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë**

- II.1. A ndikon përfshirja e prindërve në detyrat e shtëpisë për ngritjen e cilësisë në procesin e mësimnxënies?
- II.2. A është e nevojshme përfshirja e prindërve rreth detyrave të shtëpisë? Nëse po, shpjegoni përse?
- II.3. Cilat janë format më të shpeshta të ndihmës së ofruar nga prindërit për detyrat e shtëpisë?
- II.4. A ka interesim nga ana e prindërve për të parë se a kanë detyra të shtëpisë dhe në këtë aspekt çfarë është bashkëpunimi juaj me ta?

### **Kategoria 3: Përfshirja e nxënësve në detyrat e shtëpisë**

- III.1. A i kryejnë të gjithë nxënësit detyrat e shtëpisë? Nëse jo, ata që i kryejnë a janë gjithmonë të njëjtit nxënës?
- III.2. Nxënësit që i bëjnë detyrat, a tregojnë rezultat më të mirë në procesin e mësimnxënies?
- III.3. A mendoni se nxënësit janë të vetëdijshëm për ndikim e detyrave të shtëpisë në përforcimin e njohurive dhe a i shohin si të domosdoshme për të arritur rezultatet e dëshiruara?